



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Janar 2010 • Viti XXVII • Nr. 1 (183) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



HAITI – Apokalipsi i të varfërve

FAQE 6

Përgatiti:
Don Pal TUNAJ



Prania e rregulltarëve dhe kontributi i tyre në Kishën dhe në shoqërinë tonë

FAQE 10-11

Shkruan:
DON ANTON UKAJ



Shën Valentini, pajtori i të dashuruarve

FAQE 18

Shkruan:
DON DOMINIK QERIMI



“Tërmeti” i ndërgjegjes së njerëzimit

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Imzot Dodë GJERGJI, ipeshkvi i Kosovës, me rastin e përmbytjeve në Shqipëri, duke bërë apel në ndërgjegjen tonë, ndër të tjera shkruan kështu: “Të ndajmë diçka nga e jona për t’u dhuruar atyre që iu mungon më e domosdoshmja!...”

Këto ditë kemi bashkë-ndarë dhimbjen, në luftën tonë, me familjet e shumta të veriperëndimit të Shqipërisë, të cilat për të shpëtua jetën, u detyruan të lenin shtëpitë dhe pasuritë e tyre, ujërave që përmbytnin shtëpi, fshatra e qytete.

Duke përkujtuar ndihmat e shumta që na i ka dhënë Shqipëria, sidomos gjatë “eksodit” të madh, debimit dhe largimit nga shtëpitë dhe trojet tona, Ipeshkvi vijon: “... Edhe vetë jam dëshmitar, se si në atë kohë: dyert e atyre shtëpive ishin hapur për të strehuar familjet tona, ku gatubej bukë për ne dhe fëmijët tanë, se si të gjithë kërkonin sugjerime, çka mund të bëjmë më shumë. Tani kur shihet qartë se, këta vëllezër e motra tanë kanë nevojë për ne, është e nevojshme të hapin zemrën dhe kuletën, për t’u ardhur në ndihmë vëllezërve në nevojë.

Për këtë na detyron falënderimi dhe dashuria e krishterë: “Në shenjë dashurie, falënderimi dhe solidaritetit të krishterë dëshirojmë të jemi pranë vëllezërve tanë në vështirësi edhe me mbështetjen tonë materiale”.

Mu për këtë Imzot Ipeshkvi ynë ka caktuar të dielën më 24 janar ditën e grumbullimeve të mjeteve financiare dhe pakove familjare nëpër famullitë e Kosovës.

Shpresoj dhe uroj që nëpërmjet tyre do ta dhurojmë mbi të gjitha nderimin, falënderimin, një pjesë të jetës dhe të zemrës tonë vëllezërve të rrezikuar!

Nisur nga kjo ndodhi, si dhe shumë të tjera nëpër botë, mendoja kështu: “Nëna” natyrë shpeshherë “çmendet”, dhe jo vetëm se nuk e mbron njeriun, krijesën më të dalluar dhe më të çmuar të saj, por edhe e rrezikon, në disa raste bile edhe e dëmton nëpërmjet fenomeneve siç është tërmeti, vërshimi, zjarri, katastrofat natyrore.

Këto dukuri me siguri janë të lashta sa edhe bota, jeta, njerëzimi. Mirëpo sot nëpërmjet mjeteve pamore-dëgjimore, ne për së afërmi mund t’i përjetojmë dhe shohim këto ngjarje tmerruese dhe vdekjeprurëse.

Tërmeti katastrofal në Haiti, vërshimet në Shqipëri, si dhe shumë dukuri të ngjashme nëpër botë, si duket e kanë “goditur” edhe ndërgjegjen e mbarë njerëzimit. Kudo organizohet mbledhja e ndihmave për të rrezikuar, të mbi-jetuar, për ata që i kanë humbur të dashurit e tyre.

Dhe ky lloj solidariteti, bashkëpunimi, bashkëpunimi, bashkë-ndjenje, është vërtet gjë shumë e mirë, shenjë se “ndërgjegjja” e fjetur e njeriut dhe e njerëzimit, së paku në çaste dhe raste të tilla zgjohet, aktivohet, potencohet.

Me këtë del në pah një gjë e mirë dhe shpresëdhënëse: Njeriu i sotëm dhe kudo në shpirt, në zemër, në brendi, në ndërgjegje, është i mirë, i ndjeshëm, i gatshëm për të ndihmuar.

Mirëpo pyetja ime është kjo: Përse mos të jemi të tillë gjithnjë, me sy, veshë, mendje, duar dhe zemër të hapur për njëri-tjetrin? A thua duhet të ndodhin ndonjë tragjedi për t’u dëshmuar se njeriu vërtet është NJERI?

A po i shohim dhe përjetojmë ne edhe tragjeditë tjera të njeriut, të familjes dhe të shoqërisë së sotme, si varfërinë, papunësinë, sëmundjen, vetminë, dështimet, ndarjet dhe përçarjet martesore, familjare, drogën, alkoolin, krimin e shumëçka tjetër, apo vetëm tragjeditë natyrore?

“Analfabetizmi” modern, si duket, është ky: më nuk dimë, apo edhe nuk duam, ta “lexojmë” fytyrën e njeriut, të komunikojmë me njëri-tjetrin vëllezërisht dhe bashkërisht, por më tepër e bëjmë këtë me mjetet moderne të komunikimit, si gazetatat, radio, televizioni, interneti, telefoni...

Megjithatë, njeriu është NJERI, në shpirt, në zemër, në brendi, human dhe i mirë!

Si ta zgjojmë dhe aktivizojmë këtë të mirë, apo si do të thoshte e Lumja Nëna Terezë, “pjesën më të mirë të vetvetes”, mbetet çështje e hapur për të gjithë ne.

Famullia e Binçës - oazë e thirrjeve të shenja

FAQE 14

Shkruan:
Marjan Sebahj - SOPI

Intervistë me dr.Pal Lekën, kryetar i komunës së Gjakovës

Korrupsioni është kanceri i një shoqërie

FAQE 12-13



Besimtarët katolikë festojnë Krishtlindjet

Ipeshkvi ynë Imzot Dodë Gjergji, më 24 dhjetor 2009, ka organizuar një priftje solemne për personalitete vendore dhe ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përfaqësues të zyrave diplomatike, me rastin e festës së Krishtlindjes dhe Vitit të Ri 2010. Priftja u bë në Rezidencën e re Ipeshkvnore, te Katedralja në Prishtinë.

Duke i përshëndetur të pranishmit Imzot Dodë Gjergji, u tregoi se ndodhen për herë të parë në Rezidencën e re Ipeshkvnore, njëkohësisht lavdëroi punën e personaliteteve në Kosovë, dhe vlerësoi rolin e tyre për shoqërinë kosovare.

Ipeshkvi i Kosovës Imzot Dodë Gjergji, me rastin e Krishtlindjeve, u ka përcjellë

një mesazh urimi Meshtarëve, Rregulltarëve dhe Rregulltarëve, besimtarëve katolikë, si dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë për të shprehur falënderimet e tij për gjithë dashurinë dhe mbështetjen e tyre gjatë këtij viti. Festa e Krishtlindjes në kryeqytetin e Kosovës u shënu me Meshën Shenjte, e cila u mbajt në Kishën Shën Ndou, në Prishtinë. Në këtë ceremoni të shenjtë kanë marrë pjesë edhe drejtuesit e pushtetit lokal dhe Komandanti i përgjithshëm i KFOR-it Markus Bentler. Me rastin e kësaj feste, Imzot Dodë Gjergji, tha se Kosova i dërgon botës mesazhe paqeje. Meshën e ka udhëhequr ipeshkvi i Kosovës, imzot Dodë Gjergji, i cili foli për rëndësinë e kësaj

feste dhe njëkohësisht është lutur për të gjithë ata, të cilët siç tha ai, janë lënë anash kujdesit njerëzor dhe vuajnë në këtë botë.

“Lutem për të gjithë ata, të cilët janë në trishtim, nën tryshninë e varfërisë dhe të moskujdesit njerëzor, për të gjithë ata të moshuar që janë të detyruar të ballafaqohen me vështirësitë e jetës, të sëmundjeve dhe të pleqërisë, në vetmi, pa dashuri dhe të fëmijëve të tyre. Zoti qoftë mbështetje, ngushëllim dhe shpresë për të gjithë njerëzit që në çdo mënyrë vuajnë në këtë botë” – tha Imzot Dodë Gjergji.

Në Meshën Shenjte të Krishtlindjes në Kishën Shën Ndou morën pjesë një numër i madh i besimtarëve katolikë, ndërkaq të pranishëm kishte edhe qytetarë të besimit islam, të cilët në shenjë respekti, bashkërisht kanë shënuar këtë festë.

Ndërkohë Ipeshkvin e Ipeshkvisë së Kosovës, Imzot Dodë Gjergji ka marrë urime nga të gjithë liderët e institucioneve.

Edhe ditën e festës së Krishtlindjes, Meshën solemne, në Katedralen e Prizrenit, e udhëhoqi ipeshkvi ynë Imzot Doda dhe, përveç besimtarëve



Mons. Dodë Gjergji gjatë Meshës Shenjte në Prizren

të shumtë morën pjesë mysafirë tjerë, të cilët pas Meshës, në oborrin e Kishës ishte përgatitur enkas për të pranishmit një koktej. Ipeshkvin dhe gjithë

të pranishmit i nderuan edhe mysafirët e shumtë që kishin ardhur për të uruar dhe festuar së bashku me ne.

(Don Albert Jakaj)



Myftiu Naim Terriava dhe Mons. Dodë Gjergji

Festa e Familjes Shenjte në kishën e “Shën Sebastianit” në Karavansari (Malishevë)

Aty ku takohen e “vjetra” dhe e “reja” – guximi dhe gëzimi i dhjetë të pagëzuarve

Data e 27 dhjetorit, përkatësisht dita e Familjes Shenjte, për kishën tonë në Kosovë, ishte një datë më rëndësi të veçantë, ngase në Kishën e “Shën Sebastianit” në Karavansari u kremtua mesha shenjte dhe në gjirin e familjes se madhe – që është Kisha Shenjte – hyjnë edhe dhjetë antarë të ri. Meshën më këtë rast e udhëhoqi ipeshkvi i Administraturës Apostolike të

Prizrenit Imzot Dodë Gjergji së bashku me dy meshtarë të tjerë.

Edhe pse që një ditë me reshje shiu dhe më vransira, i përcjelluar edhe nga një ftohtë që donte të pengonte atmosferën dhe gëzimin e kësaj ditë, më gjithë atë kjo ditë ishte shumë e ngrohtë dhe domethënëse për të pranishmit dhe për kishën mbarë. Koha dhe vështirësit klimatike nuk ndaluan assesi gëzimin dhe harën e atyre që

për herë të parë në jetën e tyre u ktheheshin rrënjëve të etërve të tyre dhe për herë të parë përqafonin Kishën – familjen e madhe të Zotit në botë. Gëzimi shihej edhe në fytyrat e atyre që ishin të pranishëm si në fytyrën e ipeshkvit, meshtarëve, motrara të nderit dhe të shumë besimtarëve që kishin ardhur nga Klina, Zllokuqani, Dobërdoli, Velezha, Sallagrazhda, nga bashkfshatarët e të pagëzuarëve dhe nga besimtarë katolik dhe mysliman nga shumë vise të Kosovës.

Këta të pagëzuar apo besimtarë të rinj paraprakisht kishin kaluar periudhën e katekumenatit apo të përgatitjes të nevojshme për pranimin e sakramenteve të inizionit apo sakramentet hyrëse si Pagëzimi, Krezmimi, dhe Kungimi. Këtë përgatitje e realizuan me shumë dashuri dhe zell mesh-tari përgjegjës për Karavansari dhe Llapushnik don Robert Jakaj dhe motrat Françeskane të “Zojës së Paperlyer” me qendrim



në Velezhë: M. Ana Nikolla dhe M. Samuela Nikolla. Pagëzimi i këtyre dhjetë personave e ngrit numrin e të pagëzuarve në këtë fshat në shtatëmbëdhjetë veta. Por nuk mungon edhe dëshira e një numri të konsiderueshëm i atyre që janë në kërkim dhe akoma nuk kanë vendosur definitivisht apo i atyre që janë në përgatitje e sipër për të përqafuar “fenë e vjetër” siq thonë ata.

Ipeshkvi i Administraturës Apostolike të Prizrenit mons. Dodë Gjergji duke pranuar me gëzim të madh këta anëtarë të ri në gjirin e Kishës Katolike i përgëzoi për guximin duke i inkurajuar ata edhe pse janë vetëm shtatëmbëdhjetë veta, tani më ata janë pjesë e Kishës universale në katër anët e botës.

(Don Jeton Thaqi)



Të pagëzuarit e rinj në Karavansari

Festa e Shën Sebastjanit në famullinë e Peshterit

Shën Sebastjani - udhërrëfyes për jetën tonë

Në famullinë e Peshterit më 20 janar është festuar pajtori i kësaj famulle Shën Sebastjanit martir.

Famullitari i famullisë don Kolë Zefi kishte angazhuar don Dominik Qerimin, salezian me shërbim në Gjilan, për të celebruar meshtën kryesore.

Don Dominiku në pretkun e rastit, përveçse foli për jetën e këtij shenjt, ai gjithashtu ftoi të pranishmit që shembulli dhe mësimi i Shën Sebastjanit të jetë

gjithmonë udhërrëfyes edhe për jetën tonë.

Predikatori gjithashtu ceku dhe shpaloji kujtimet e tij studentore, që si student kishte ardhur nga Prishtina në Peshter për të bërë përvojë pastorale dhe për të ndihmuar vëllezërit e tij. Ai nënvizoi që përshpirtëria, thjeshtësia, bujaria dhe mikpritja e njerëzve të vendit kishin lënë një përshpirtëri dhe një kujtim shumë të mirë në jetën e tij.

Në mbarim të meshtës, famu-

llitari don Kolë Zefi, falënderoi Zotin që me ndërmjetësinë e Shën Sebastjanit vazhdon të zbrazë hirit dhe bekimet e veta; gjithashtu falënderoi edhe meshtarët e pranishëm si dhe besimtarët e shumtë që kishin ardhur nga famulli të ndryshme, e veçanërisht mërgimtarët që kishin ardhur për të festuar me të afërmit e tyre.

(DritaPress)

Festa e Shën Sebastjanit në Karavasari

Shën Sebastjani - i cili nuk e mohoi fenë e vet

Të mërkurën më 20 janar famullia e Karavasarisë (Mali-shëvë) e kremtoi festën e pajtorit të vet, shën Sebastjanin, apo siç njihet në popull sh'Masianin.

Meshtën e sivjetme e udhëhoqi Dr. Don Lush Gjergji, bashkë me të koncelebruan edhe disa meshtarë të tjerë nga Kosova dhe Mali i Zi, të cilët para meshtës ndan edhe Sakramentin e Pajtimit - Rrëfimin.

Edhe pse moti ishte i ftohtë don Lushi me predikimin e tij të mrekullshëm arriti që t'i ngrohë zemrat e shumë besimtarëve që kishin ardhur nga tërë Kosova.

Don Lushi me pretkun e rastit theksoi mbi jetën e një pape (shën Fabiani), dhe një Laiku, i cili nuk e mohoi fenë e vet (shën Sebastjani). Ai e vlerësoi lart figurën e sh'Masianit. Vetë nderimi që ka populli shqiptar për këtë shenjt, tregon lashtësinë e kishës dhe mësimin të Krishtit në këto troje dhe në këtë popull.

Ky popull duhet t'i mbetet



besnik Krishtit, sikurse ky shenjt i mbeti, edhe me çmimin e jetës së vet.

Shën Fabiani, i cili mohoi për të flijuar para idhujve, u dënua në një nga qelitë e tmerrshme të burgjeve romake dhe e lanë aty, derisa u shua nga etja e nga uria.

Shën Sebastjani ishte i lidhur për një trung në fushë të hapur dhe e mbytyt duke e qëlluar me shigjeta, për arsye se nuk e mohoi që ishte i krishterë.

Në fund të meshtës Don Al-

bert Jakaj i falënderoi vëllezërit meshtarë, korin e udhëhequr nga Motra Ana Nikolla dhe Motra Samuela Nikolla, të cilët na kanë hijeshuar liturgjinë me këndimin e tyre engjëllor. Po ashtu Don Alberti iu uroi festën të gjithë besimtarëve që e kremtojnë këtë festë, në mënyrë të veçantë besimtarëve të Karavasarisë, dhe njëheri ju uroi edhe për katër vjetorin e bekimit të kësaj kishë.

(Mimoza Raja)

Festa e Shën Sebastjanit në famullinë e Binçës

Nuk ka dashuri më të madhe se ta pranosh vdekjen për të afërmin tënd

Edhe në famullinë e Binçës shumë familje me miq dhe dashamirë e lusin dhe e nderojnë festën e Shën Sebastjanit. Në një ditë me diell, por mjaft të ftohtë, besimtarët e shumtë të famullisë së Binçës dhe të famullive për rreth ishin bashkuan në kishën famullitare për të kremtuar meshtën shenjte në nder të shën Sebastjanit.

Meshtën shenjte e udhëhoqi don Marjan D. Ukaj, kapelan në famullinë e Klinës. Don Marjani në pretkun e rastit foli për figurën e këtij shenjt të madh të Kishës së parë, duke vënë në pah besimin dhe guximin që ky shenjt kishte. Sebastjani në thjeshtësinë më të madhe

që mëson krishterimi, diti t'i bëjë ballë vështirësive të kohës. Në këtë shkollë, Sebastiani, nxënës i vërtetë dhe besnik i Jezu Krishtit, bëri para njerëzve dëshminë supreme të dashurisë: "Nuk ka dashuri më të madhe se ta pranosh vdekjen për të afërmin tënd".

Në bashkë-meshim morën pjesë edhe shumë meshtarë të tjerë. Në fund të meshtës famullitari i Binçës don Albert Demaj falënderoi të gjithë të pranishmit duke uruar që ndërmjetësia e shën Sebastjanit t'i shpërblejë njetet e të gjithëve.

(DritaPress)



Të bashkuar në emër të së Mirës

Kush jemi ne? Ne jemi grupi vullnetar i Caritasit të famullisë së Prizrenit të quajtur "PPCPG" (Grupi Nxites i Caritasit të famullisë së Prizrenit). Sakrifikuem të kohës dhe të vetes, të motivuar me dëshirë dhe qëllim të mirë, jo si shërbyes, por ndiejmë kënaqësinë e vullnetarizmit, një grup me shumë energji pozitive i cili e shikon të ardhmen pozitivisht, grup që punon për të mirën e shoqërisë, grup që mund të bëjë energjinë pozitive dhe të kyçë shumë persona në punë me vetëdëshirë, solidarë në nevojat aktuale, grup që është i gatshëm të ndihmojë në çdo kohë, shpresdhënës, i besueshëm, grup që dashuron, grup që ka ndjenja, fleksibil që adaptohet me përfituesit dhe udhëheqësin, grup që ndihmon në zhvillimin e shoqërisë, grup që sakrifikon i motivuar me dëshirë të mirë. Grupi PPCPG u formua në vitin 2004 duke iu falenderuar profesor Heinrich Schurad.

serbë.

7. Përvoja e vullnetarëve të PPCPG-s në shëtitje dhe takime të ndryshme kulturore dhe formative.

8. Organizime të ndryshme brenda famullisë.

9. Organizimi dhe përgatitja e dramave mistike për Krishtlindje dhe Pashkë.

10. Projekti PSM- promovimi i vullnetarizmit në Ipeshkvi.

Vitin e kaluar ne vullnetarët e famullisë së Prizrenit kemi implementuar projektin "Promovimi i Vullnetarizmit" që kishte si qëllim forcimin e rrjetit ndërmjet grupeve të vullnetarëve të famullive (Klinë, Pejë, Zllakuqan, Novosellë, Prishtinë dhe Prizren), në mënyrë që të rritet dhe forcohet koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet vullnetarëve dhe aktivitetëve të tyre. Kemi vizituar këto famulli të lartpërmendura dhe kemi pasur takime me grupe të ndryshme të të rinjve, me çrast jemi informuar me aktivitetet e



Me çka merremi ne?

1. Me aktivitetet të ndryshme (si p.sh. mësim edukativ, muzikë, teatër, ekskursione, shpërndarja e dhuratave për festat e fundvitit etj.) ne institucionet për personat me aftësi të kufizuara: Projekti i Mësimin, Edukimi i Hershëm, Çerdhja Speciale, po ashtu edhe bashkëpunimi me Çerdhen "Nëna Cabrini".

2. Mbledhja e informatare për grupe të ndryshme të njerëzve me aftësi të kufizuara në Prizren.

3. Punimi i Broshurës: "Edhe ne jemi pjesë e shoqërisë kosovare" që ti informojmë prindërit, dhe të gjithë njerëzit që janë të interesuar për ndihmesën e këtyre personave dhe sensibilizimin e tyre në shoqërinë kosovare.

4. Detektimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara.

5. Karnevalet - Vazhdimi i traditës së festës së Karnavaleve me vullnetarët e famullive të ndryshme dhe me të rinjtë dhe fëmijët e Prizrenit.

6. "10 Milion Yje" - ku tema është promovimi i vullnetarizmit dhe solidaritetit në Kosovë dhe e veçantë është mbledhja e komuniteteve të ndryshme në Prizren si: romë ashkali, boshnjakë dhe

tyre dhe kemi shpalosur punën dhe planin tonë. Këtë vit duhet të fillojmë me vazhdimin e takimeve dhe implementimin e aktivitetëve të parapara nga vullnetarët dhe zgjerimin e rrjetit ndërmjet famullive të tjera.

Vullnetarizmi krijon besim dhe vetërespekt; mëson shkathtësi për punë; bashkon vullnetarët dhe bashkësitë e tyre; ndihmon në krijimin e aftësive komunikuese dhe shoqërore; lejon të bësh ndryshim të vërtetë në botë; të jep mundësi të madhe dhe të mrekullueshme për të bërë miq të rinj dhe sigurim mundësitë për të zbuluar aftësitë, talentin e interesat individuale dhe testimin në mjedis të vërtetë.

Për punën, mirëkuptimin, përkrahjen dhe ndihmën që kemi hasur gjatë vitit të kaluar e falënderojmë Zotin dhe të gjithë njerëzit që kemi takuar gjatë misionit tonë dhe njëkohësisht kërkojmë ndihmë dhe përkrahje edhe për të ardhmen tonë, që, duke vepruar, të mbjellim farën e dashurisë dhe të shpresës tek të gjithë njerëzit me të cilët punojmë dhe veprimë.

(Ida Delbysa, Prizren)

In memoriam

Përvjetori i katërt i kalimit në amshim
i mons. Mark Sopit, ipeshkëv

Të dielën me 10 janar të vitit 2010 në Katedralen e Prizrenit u kremtua Mesha përkujtimore për shpirtin e Ipeshkëvit të Kosovës mons. Mark Sopi.

Meshën Shenjte e udhëhoqi ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji. Ipeshkvi ynë, në pretkun e rastit, përveçse të përkujtoi figurën dhe kontributin e madh që mons. Mark Sopi i kishte dhuruar Kishës dhe shoqërisë gjatë një dekade të tërë shërbimi dhe flimij ai gjithashtu ftoi besimtarët që të lutën për shpirtin e tij.



Ndërsa, të hënë me 11 janar ditën e vdekjes së tij, në famullinë e Binçës - vendi i lindjes dhe varrimit - u celebrua një Meshë përkujtimore nën udhëheqjen e famullitarit të Velezhës don Marjan Markut.

Edhe gjatë kësaj dite kujtimi dhe lutja për shpirtin e mons. Mark Sopit e bashkoi klerin dhe besimtarët jo vetëm në Kishën e Prizrenit dhe të Binçës por edhe në të gjitha famullitë tjera të Kosovës.

(DritaPress)

In memoriam

Mons. IVAN PRENGJA, Arqipeshkv i Zarës – Kroaci

(31. 12. 1939 – 25. 02. 2010.)

Të hënë me 25 janar 2010 në Zagreb vdiq arqipeshkvi i Zarës monsinjor Ivan Prengja (Prenda). Monsinjor Prengja vdiq në moshën 71 vjeçare, 46 vjet meshtar dhe 20 vjet arqipeshkv. Lindi nga familja arbanase (arbanas – arbëreshë të Zarës në Kroaci) me 31 dhjetor të vitit 1939 në Zemunik, nga i ati Jure dhe nëna Ike.

Gjimnazin e përfundoi në Zarë kurse studimet filozofiko – teologjike në Zagreb.

Shugorohet meshtar më 29 qershor të vitit 1964.

Nga viti 1968 ishte profesor i teologjisë pastorale në shkollën e lart teologjike në Zarë. Papa Gjon Pali i Dytë e emron arqipeshkëv ndihmës të Zarës me 29 mars 1990, kurse me 9 qer-



shor të po ati viti shugorohet ipeshkëv nga arqipeshkvi i Zagrebit, kardinali Franjo Kuharić.

Detyrën e arqipeshkëvit të Zarës e merr me 2 shkurt 1992. Arqipeshkvi Prengja do vorroset në katedralen e Zarës të prem-tën me 29 janar 2010.

Monsinjor Ivan Prengja gjatë gjithë jetës kishte kontakte me shqiptar dhe Kishen katolike në trojet Shqiptare, sepse siç thosh-

te „UNË JAM ARBANAS“ që do të thotë Arbëreshë.

Arbanasit – arbëreshët në Zarë të Kroacisë i përkasin periudhës së shekullit 18, të cilët janë me prejardhje nga rreth i liqenit të Shkodrës (Shestani)

Ritet e salikimit të ipeshkëvit të ndier mons. Ivan Prengja u mbajtën me datën 30 janar në katedralen e arqipeshkëvisë së Zarës. Në përcjelljen e fundit të kësaj figure të madhe të kishës morën pjesë shumë ipeshkëvijë nga Kroacia dhe rajoni e nder ta edhe ipeshkvi i ynë mons. Dodë Gjergji. Shpirtin e ipeshkëvit të ndier mons. Ivan Prengja jua besojmë Atit të mëshirshëm. Pushoft në Paqe!

(Marrë nga

www.kisha-katolike-gjakove.com)

Kisha Katolike në Kosovë ndihmoi zonat e përmbytura

Pas katastrofës natyrore që ndodhi para pak kohësh në zonën e Shkodrës, ku dëmet ishin të mëdha, filluan nga të gjitha anët të mblidhën ndihma për këto zona.

Së pari vet Shteti shqiptar dha kontributin e vet për evakuimin e njerëzve dhe të pasurisë në ato zona, pastaj ishte intervenimi i forcave të NATO-s, të Forcës së Sigurisë të Kosovës, të komunave të ndryshme të Kosovës.

Edhe Kisha Katolike në



Kosovë ju doli në ndihmë këtyre banorëve.

Aksioni për grumbullimin e mjetëve, gjërave ushqimore dhe veshmbathjes u inicua nga ipeshkëvi i Kosovës mons. Dodë



Gjergji, dhe u realizua nga besimtarët e famullive të kësaj ipeshkëvie.

Caritasi i Kosovës bëri grumbullimin e mjetëve anëkend Kosovës dhe i drejtoi për në Shkodër.

Ndihma përbëhej prej disa mauneve, ndërsa në regionin e Gjakovës u grumbulluan 5050 kg miell, 11 thasë patate, 3 thasë fasulë, 350 pako ushqimore dhe veshmbathje, si dhe një numër i mjetëve matëriale.

Kjo ndihmë edhe pse e vogël, tregon solidarizimin e popullatës këtu me zonat që përjetuan përmbytjet.

(Marrë nga

www.kisha-katolike-gjakove.com)

Polemika

Papa Pio XII: dyshime me
Luftën e Dytë BotëroreGumpel: «Deri në vitin 1939
arkivat janë të hapura: pse
askush nuk i konsulton?»

Nga zyra e tij në Rome, në selin e Kuries gjenerale të Shoqërisë së Jezusit, padre Peter Gumpel – re-latori për beatifikimin e Pios XII – e komenton në mënyrë pozitive lajmin se papa është një person i shenjtë. Nuk është një sodisfacion legjitim: Jezusit gjerman e thotë këtë si një sinjal i rëndësishëm ndaj një të vërtete historike.

“Jam më shumë i bindur në shenjtërinë e tij edhe nëse do të zbulohet ndonjë dokument në arkivin sekret të Vatikanit që mund të kontaminon këtë bindjen time, atëherë do të isha unë i pari që do ta shpallja një kontaminim të tillë.

“Para së gjithash dëshiroj të shtoj edhe diçka se tërë bota hebraike është kundër lumturimit të tij, por vetëm një grup prej tyre e bën këtë. Mendoj ne hebrenjtë në Amerikë, të cilët janë falënderues ndaj asaj që bëri Pio XII për ata, që shpëtoi mijëra jeta njerëzore, dhe nëse i lexojmë arkivat e Vatikanit ne e shohim një Pacelli në Bavari dhe si sekretar i Pio XI shumë të ndryshëm nga ai që e ka prezantuar Rolf Hochhuth në dramën “Il Vicario”.

Gumpel shton ndër të tjera se janë disa dokumente që e mbrojnë shumë kancelari të shteteve të ndryshme të botës: dhe pyes veten pse këto nuk janë studiuar? Ndër të tjera i kemi edhe dokumentet e tjera që Papa Pio XII e ka dënuar ashpër racizmin dhe nazizmin ndërsa të tjerët e akuzojnë heshtjen e Pio XII që thonë se kjo heshtje ka kushtuar jetën e miliona njerëzve.

Edhe domenikani Ambrosius Eszser, ky ka bërë disa kërkime ndaj lumturimit të Papës Pio XII e ka bërë publike bindjen e tij nga

lumtimitet e ndryshme: «Çdo kërkim që kam bërë është i qartë se Papa Pio XII është një person i shenjtë për atë që ka bërë gjatë periudhës më të rëndë historike botërore”.

Patër Ambrosius Eszser ka bërë kërkime për dhjetë muaj me radhë në arkivat sekrete të Vatikanit dhe në arkivat e shteteve të ndryshme që kishin lidhje me nazizmin për të bërë dritë mbi figurën e Pios XII që shkon nga vitet 1939 deri në vitin 1945.

Nga kuvendi i Shën Palit në zemër të Berlinit në moshën 77-vjeçare padre Eszser një studium i madh në Doktrinën e Fesë ndër të tjera shton duke marrë lajmin se Eugenio Pacelli – Papa Pio XII – është zyrtarisht “i pranuar për lumturim e shenjtërim” mendoj se pasi të më jepet leja ty bëj kërkime në arkivat e Vatikanit do të zbulojë më shumë dhe do të zbardhë shumë fakte të Pastor Angelicus.

Padre Eszser thotë se «Më ka bërë surprizë të madhe diplomacia e fshehtë dhe paralele e vendeve si Çekosllovakia, Hungaria që nëpërmjet angazhimit të Selisë Apostolike kanë shpëtuar mijëra shpirta. Mendoj pastaj në atë letër të protestës të arqipeshkëvit të Bratislavës Adolf Bertram që i drejtohet Hitlerit në të cilën kardinali e kundërshton ligjin marcial ushtarak të Hitlerit ndaj martësve të përzierja me hebrenj, duke i kërkuar t'i shpëtojë ata». Por te vetë përzierja e Italisë në regjimin e Hitlerit shumë gjëra kanë ndryshuar.

Këto sqarime dhe shumë të tjera të detajuara i kanë bërë të mundshme takimet e herëpashërme mes Papës dhe bashkësisë hebraike dhe lëvizjeve tjera përbrenda ketyre dy bashkësi fetare.



Papa në Sinagogën e Romës: vlerat e mëdha të dy feve

Vizita e Papës Benediktit XVI në Sinagogë të Romës, pa dyshim është ngjarje historike. Pra, gati 24 vjet pas vizitës së Gjon Palit II në Tempullin hebraik, për të dytën herë një Papë vizitoi Sinagogën e Romës. Pikërisht në Ditën e dialogut ndërmjet katolikëve e hebrenjve, që në Itali i mbush 20 vjet, Papa Racioger poohoi edhe një herë se udha e miqësisë ndërmjet dy bashkësive fetare është e pakthyeshme: "Hebrenjtë e të krishterët - tha Benedikti XVI - në sajë të rrënjëve të tyre të përbashkëta, me të gjitha dallimet që kanë mes tyre, janë të thirrur ta dëshmojnë së bashku një Zot të vetëm e Dekalogun (Dhjetë Urdhërimet), kodin e madh etik për mbarë njerëzimin".

Në fjalimin e tij Papa kujtoi se janë të shumtë katolikët që reagueshan me guxim duke hapur krahët e dhënë ndihmën e tyre për hebrenjtë e përndjekur nga nazifashizmi dhe kujtoi se Selia e Shenjtë pati ndërmarrë nisma të ndryshme në fshehtësi e pa zhurmë për të ndihmuar hebrenjtë e përndjekur.

Edhe Kryerabini i Bashkësisë Hebraike të Romës, Rikardo Di Senji, nënvizoi se, përkundra problemeve që ende janë të hapura e moskuptimeve ekzistuese, janë synimet e përbashkëta që duhet vënë në plan të parë. "Kemi një ëndërr - tha Kryerabini Di Senji - atë që të bëjmë që kjo ngjarje, përtej vëmendjes së mediave e ceremonisë rituale, të mund të ketë një ndikim tek personat në mënyrë individuale. Prej ditës së sotme kemi përgjegjësinë t'i mishërojmë synimet tona e ëndrrat tona t'i bëjmë realitet, ta shembim murin e dyshimit e të frikës, ta hapim zemrën tonë e tyre për ta njohur tjetrin, të afërmin". Ndërsa kryetari i bashkësisë hebraike të Romës, Rikardo Paçifiçi, foli për një ngjarje që do të ketë ndikim të thellë në marrëdhëniet ndërmjet botës hebraike e asaj të krishterë. Takimi ndërmjet hebrenjve e

të krishterëve përbënë një ndër çështjet më komplekse të shekullit XX që ka qenë, siç e kujtoi Papa Benedikti XVI gjatë vizitës së tij në Sinagogën e Romës, "një epokë tragjike", po Ati i Shenjtë u ndal tek rikuperimi i kuptimit transcendent në një shoqëri që po shkoi drejt "harresës së Zotit". Papa i ftoi hebrenjtë të bashkohen me Kishën katolike në betejën për mbrojtjen e mesazhit etik të përbashkët që buron nga Dekalogu që Hyji i dha Moisiut e të cilin dy bashkësitë e njohin si themel të marrëdhënies ndërmjet Hyjit e njeriut dhe të marrëdhënies ndërmjet njeriut e njeriut. Në fjalimin e tij Papa nënvizoi pika themelore janë: zgjimin i kuptimit transcendent në botën aktuale; mbrojtja e jetës kundër çdo keqpërdorimi e nëpërkëmbjeje; promovimin i shenjtërimit të familjes.



Në atmosferën e respektit të madh e të dialogut ndërmjet dy bashkësive fetare, sipas Papës, marrëdhënien janë pjekur dhe ka ardhur koha e angazhimit të përbashkët "për të vlerësuar atë çka

na bashkon: fenë në një Zot të vetëm, para së gjithash, por edhe mbrojtjen e jetës e të familjes, aspiratën për drejtësinë shoqërore dhe paqen".

"Papa në Sinagogën e Romës: kujtimi i së kaluarës dhe Urdhërimet e Tenzot baza e dialogut".

Ati i Shenjtë shkoi për vizitë në bashkësinë hebraike të Romës e në Tempullin e Madh, që ndodhet mjaft afër Vatikanit. Bashkësia hebraike është shumë e vjetër në Romë. Që në vitet 70 pas Krishtit ka dëshmi për praninë e hebrenjve në kryeqytetin e sotëm italian. Benedikti XVI deshi kështu të ndjekë gjurmët e paraardhësit të tij, Gjon Palit II, i cili pati vizituar Tempullin e Madh të Romës, më 13 prill 1986.

Pikërisht në shkallët e Tempullit, Papa u prit nga Kryerabini Rikardo Di Senji. Pas një minuti



mund të ketë ndikuar në ndonjë farë mënyre për të hapur plagët e antisemitizmit dhe të antijudaizmit në botë. E në këtë vazhde, Ati i Shenjtë kujtoi edhe deportimin e hebrenjve të Romës në

zoi trashëgiminë e përbashkët të hebrenjve dhe katolikëve e vuri në dukje se në dhjetë Urdhërimet e Tenzot, apo në "Dhjetë fjalët", siç i quajnë hebrenjtë, mund të gjenden fushat e bashkëpunimit e të dëshmisë së përbashkët. E Papa përmendi tre prej tyre: "Dhjetë fjalët" kërkojnë në të njohim një Zot të vetëm, kundër tundimit për të ndërtuar idhuj të tjerë, apo vija të artë... "Dhjetë fjalët" kërkojnë respektin e mbrojtjen e jetës, kundër çdo padrejtësie e abuzimi, duke njohur vlerën e çdo njeriu, krijuar në shembëlltërinë e në ngjashmëri me Zotin... "Dhjetë fjalët" kërkojnë të ruhet e të nxitet shenjtëria e familjes, në të cilën "po"-ja personale e reciproke, besnike dhe përfundimtare e burrit dhe e gruas, krijon hapësirë për të ardhmen, për humanitetin e vërtetë të secilit dhe njëkohësisht, hapet para dhuratës së jetës së re".

Papa përmendi, ashtu siç bëri më parë kryerabini Di Senji, dialogun ndërmjet katolikëve dhe hebrenjve dhe mbledhjen e Komisionit të përzier që pikërisht nesër do të diskutojë në Romë mbi temën "Mësimi katolik dhe ai hebraik mbi gjithësinë dhe ambientin". Benedikti XVI përfundoi duke iu lutur Zotit për dhuratën e paqes në Tokën Shenjte. Pas lutjes tradicionale hebraike "Ani Maamin", Ati i Shenjtë zhvilloi një takim privat me rabinin Rikardo Di Senji, për të dalë pastaj në oborrin e Tempullit, ku është mbjellë ulliri që kujton këtë vizitë e për të shkuar në Muzeun hebraik të Romës, ku u përfurua ekspozita "Et Ecce gaudium" me 14 vizatime të përgatitura në vitet '700 nga Bashkësia Hebraike për kurorëzimin e Papëve. Me pastaj, Benedikti XVI u takua me disa përfaqësues të bashkësisë hebraike në Sinagogën spanjolle për t'u kthyer më pas në Vatikan.



heshtjeje për viktimat e tërmetit në Haiti, kryetari i Bashkësisë hebraike të Romës, Rikardo Paçifiçi, ai i Bashkësisë hebraike italiane, Renzo Gatenja dhe vetë kryerabini i drejtuan Atit të Shenjtë një përshëndetje, duke i uruar mirëseardhjen.

Në fjalimin që mbajti, Benedikti XVI vuri në dukje se dialogu ndërmjet të krishterëve dhe hebrenjve ka marrë hov të ri që nga Koncili II i Vatikanit dhe nuk mund të kthehet mbrrapa. Duke kujtuar shfarosjen e hebrenjve nga nazistët, Papa, pasi dëgjoi falënderimet e përfaqësuesve hebraikë për guximin e anëtarëve të Kishës që fshehën judej, përmendi edhe se Gjon Pali II pati kërkuar falje për gjithçka që

kampet e përqendrimit, sidomos në Aushvic. Nuk është e mundur të harrohen fytyrat, emrat, lotët, dëshpërimi i tyre, theksoi Papa: "Fatkeqësisht, shumë mbetën indiferentë, por shumë, edhe ndër katolikët italianë, të mbështetur nga feja e mësimi i krishterë, reagueshan me guxim, duke hapur krahët për të ndihmuar hebrenjtë e ndjekur, shpesh edhe me rrezik jete, duke merituar mirënjohjen e përhershme. Edhe Selia Apostolike ndihmoi, shpesh fshehtas e pa u dukur. Kujtimi i këtyre ngjarjeve duhet të na shtyjë të forcojmë lidhjet që na bashkojnë, që të rritet gjithnjë e më shumë mirëkuptimi, respekti e mikpritja".

Më pas, Ati i Shenjtë nënvizoi

HAITI – Apokalipsi i të varfërve

(Rreth 200.000 viktime dhe bota perëndimore hesht dhe i mbyll sytë para kësaj tragjedie)

Tërmeti që e goditi ishullin më të varfër duke shkatërruar qytete, dhe me viktime që e arrijnë numrin mbi 200.000. Haiti është një vend 175 % e popullatës jeton me 2 dollarë në ditë. Ky vend i shkatërruar u shkatërrua edhe nga një katastrofë natyrore.

Vendi është i banuar nga 9 milionë banorë dhe në të kaluarën ka qenë e goditur nga 4 stuhi tropikale dhe uragane që në vitin 2008 e ka vrarë 800 veta.

Bota perëndimore është në këtë rast duke e dëshmuar solidaritetin vetëm në fjalë, por këtij vendi i nevojitet konkretizimi i solidaritetit në veprë. Për ditë të tëra banorët kanë bërë barrikada me trupa të vdekur nëpër rrugë si shenjë proteste ndaj Botës Perëndimore që nuk kanë ardhur në ndihmë, rreziku tjetër është epidemia për shkak mos varrosjes së trupave, Haiti ka qenë dështimi i botës perëndimore dhe organizatave humanitare, së paku në javën e parë.

Në këtë ishull të karaibeve u shtrua një e keqe mbi të këqijat tjera në vend, duke e shkatërruar totalisht vendin. Në këtë vend ku një fëmijë në 5 vdes dhe ku moshë mesatare arrijnë deri në 46. Pra në këtë vend rrugët janë bërë varreza me 70.000 trupa të vdekur. Ky vend e ka edhe një sinonim me të cilën bota e quan "Vendi vetëvrasës" për shkak luftërave civile, epidemive, uraganeve dhe varfërisë.

Situata nuk është përmirësuar aspak, kjo është dëshmia e mjekëve pa kufij që veprojnë atje. Mijëra fëmijë kanë mbetur bonjakë që enden rrugëve dhe kërkojnë strehim, ushqim, mjekim. Kjo pra është toka e skllëvrve, të cilët u bënë padronë të vendit të tyre, një herë ka qenë koloni franceze, pastaj spanjolle për disa vite e okupuar edhe nga ShBA, kjo republikë e zezë është dalluar çdo herë nga feja e tyre e fortë. Në

një shkrim në mure të kryeqytetit shkruan: "Zoti është i mirë, nesër do të shohim çka do të ndodhë".

Tërë bota duhet ta ketë shikimin e drejtuar në Port-au-Prince dhe në trupat e vdekur nëpër rrugë dhe nën rrënoja. Ata që e kanë ndjerë veten të tronditur pasi kanë parë në tv katastrofën natyrore ndoshta ka qenë një moment i errtë edhe i jetës fetare, që nëpërmjet kësaj tragjedie kemi lexuar shume momente të jetës personale. Nëpërmjet kësaj bëhet një arsye pozitive ndaj një fenomeni që shpesh flitet në mënyrë negative, mbi globalizimin. Tërë bota e ka mbajtur larg shikimin nga kjo që po e themi, mbi vajin e fëmijëve, larg shikimin nga shikimi i trishtueshëm i atyre njerëzve të humbur përpara një realiteti ku kanë humbur jetën dhe të dashurit. Pas disa ditëve (me vonesë) janë nisur ndihma, vullnetarë, shoqata dhe Ong pri-



vate. Nëpërmjet kësaj është bërë e ditur se bota është e ndarë në të pasur e në të varfër në mënyrën më ekstreme dhe ksenofobike dhe raciale.

Njerëzit i bëjnë pyetjet e tyre rreth botës dhe Zotit: si është e mundur që Zoti të lejojë një gjë të tillë në një vend të varfër, a nuk janë të varfërit të mbrojturit e Zotit?

E kështu na këshillohen leximet e 17 janarit, Ditës kushtuar Emigrantëve: "Nuk do të qubesh më 'E lëna', toka jote më s'do të qubet 'E shkretuar', por do të qubesh 'Kënaqësia ime' e toka jote 'E martuar',

sepse ti i pëlqevë Zotit" (Isaia 62, 1-5); "Dhuratat janë të ndryshme, por Shpirti Shenjt është i njëjtë edhe shërbesat në përhapje të Ungjillit janë të ndryshme, por Zoti është i njëjtë po edhe mënyrat e veprimit janë të ndryshme, por Hyji është i njëjtë. Ai bën gjithçka në të gjithë. Secili merr dhuratë të veçantë të zbulesës së Shpirtit Shenjt për të mirën e përbashkët." (1Kor 12, 4-11), është shpresa e garantuar nga Zoti që për krijimin e tij shërbeht neper njeriun.

Përgatiti: Don Pal TUNAJ

Peshkopi i Nishit Irinej është Patriarku i ri i Kishës ortodokse serbe

Dy muaj pas vdekjes së kreut të Kishës ortodokse serbe Pavle, i cili u nda nga jeta në moshën 95 vjeçare, anëtarët e Sinodit të shenjtë të Kishës ortodokse serbe para disa ditë e zgjedhën peshkopi e Nishit Irinej në krye të kësaj Kise.

Zgjedhja e Patrikut të ri u bë sipas procedurave të caktuara, me hedhjen sipas shortit ndër të emra të votuar që kanë numrin më të madh të preferencave. Në tri zarfe me emrat e Irinejt të Nishit, të ipeshkvit Irinej të Backës e metropolitit të Malit të Zi, Amfilohije, ky i fundit që nga nëntori e ka udhëhequr Patriarkanën, Locum tenens i fronit patriarkal.

Personi që zgjodhi, sipas shortit, rastësisht zarfin, me emrin e peshkopit të Nishit, Irinej, 80 vjeç, ka qenë arkimandriti Gavrillo i manastirit të Lepavinit.

"Ka qenë vullneti i Zotit e vullneti i Sinodit të Shenjtë", këto janë fjalët e para që i tha peshkopi Irinej i Nishit, 80 vjeç, menjëherë pas zgjedhjes së tij në postin e

Patrikut të Kishës ortodokse serbe.

"Në këtë detyrë të nderuar e të vështirë jam zgjedhur me ndihmën e vëllezërve ipeshkvij, me të cilët do të bashkë-ndajë peshën e funksionit të tillë e të gjitha problemet" që Kisha ortodokse serbe ka para vetes, shtoi Irinej, emri i të cilit në pagëzim është Miroslav Gavriloviç. Lindur në vitin 1930 në fshatin Vidova, pranë Caçakut, Irinej ka studiuar në seminarin e Kishës ortodokse serbe në Prizren të Kosovës, e pastaj studimet teologjike në Universitetin e Beogradit. U bë murg në manastirin e Rakovicës, pranë Beogradit, në vitin 1959. Ka qenë profesor në seminarin e Prizrenit e pastaj vijon studimet pas universitare në Athinë në vitet 1962-1963. Në vitin 1974 emërohet peshkopi i Nishit. Disa herë ka qenë anëtar i Sinodit të Shenjtë, organizmit më të lartë të udhëheqjes së Kishës ortodokse serbe.

(Marrë nga Radio Vatikani)

Simon Kananeu dhe Juda Tadeu

■ PËRGATITI:
Don Marjan MARKU

Lexus të dashur, kësaj here do të marrim në shqyrtim dy apostuj nga lista e 12 apostujve: Simon Kananeu dhe Juda Tadeu (mos ta ndërtojme me Judë Iskariotin). Po i marrim këta dy apostuj jo për shkak se gjenden njëri pran tjetrit (Krah. Mt 10,4; Mk 3,18; Lk 6,15; Vap 1,13) por për shkak se kemi shumë pak të dhëna mbi ta dhe për atë arsye i kemi marrë së bashku, por edhe pse kanuni i shkrimeve të Besëlidhjes së re ka edhe një letër të cilën e ka shkruar Juda Tadeu.

Simoni ka edhe një emër, i cili ndryshon tek Ungjilltarët, tek Mateu dhe Marku ai quhet "Kananeu" ndërsa tek Luka dhe Gjoni ai quhet "Zelltar". Në realitet të dy thënie e kanë të njëjtin kuptim: Verbi hebraik *qanā* do me thënë »xheloz, me qenë i flaktë« dhe kjo thënie mund të jetë e përcaktuar nga Hyji – që ai me xheloz të mbikëqyrë mbi popullin e zgjedhur (Krah. Dal 20,5) –, por gjithashtu edhe për njerëzit të cilët shërbejnë me zell të flakët duke u djegur dhe dhuruar plotësisht për Hyjin, sikurse bëri edhe Elia (Krah. 1 Mbr 19,10). Edhe pse ky Simon nuk ishte anëtarë i lëvizjes nacionale të Zelotëve (Zelltarëve), është shumë e mundshme se ai ka qenë i zellshëm për identitetin e judenjve edhe në këtë mënyrë për Hyjin, për popullin e tij dhe për ligjin e Hyjit. Nëse bëjmë krahasime në mes Simonit dhe Mateut i cili ishte tagrambledhës ata qëndrojnë diametrisht larg njëri prej tjetrit, sepse tagrambledhësit ishin në sy të popullit si njerëz të papastër. Këtu shohim një shenjë të qartë të Jezusit i cili nxënësit e tij i ka zgjedhur prej klasave të ndryshme shoqërore dhe religjioze duke mos e përjashtuar askënd nga rrethi i tij. Ai ishte dhe është i interesuar për njerëzit dhe jo për kategoritë shoqërore apo për gjykime të njerëzve! Gjëja më e mirë tek nxënësit e tij ishte se ishin të bashkuar edhe pse ishin të ndryshëm dhe kështu i tejkalonin të gjitha vështirësitë. E vetmja arsyeja e një qëndrimi të përbashkët ishte vet Jezu Krishti, në të cilin të u bashkonin të gjithë. Ky është një mësim i mirë për ne, të cilëve ndryshimet shpesh-

herë na ndajnë. Në Jezusin ne të gjithë mund të bashkohemi. Nganjëherë ne harrojmë se në Jezu Krishtin ne mund të fitojmë forcë për ti tejkaluar konfliktet tona. Ta përkujtojmë se grupi i dymbëdhjetë apostujve është një shëmbëlltë e Kishës në të cilën ka vend për të gjitha karizmat, për të gjithë popujt, rasat dhe vetitë njerëzore, që të qëndrojnë së bashku në bashkësi me Jezu Krishtin.

Çka i përket Juda Tadeut, është quajtur me dy emra të ndryshëm për shkak të traditës: deri sa Mateu dhe Marku e quajnë atë thjeshtë: »Tadeu« (Mt 10,3; Mk 3,18), ndërsa Luka e quan »Juda, biri i Jakobit« (Lk 6,16; Vap 1,13). Emri Tadeu ka prejardhjen e pasigurt dhe sipas gjitha gjasave rrjedh nga gjuha arameje *taddā*, që do me thënë »gjoksi« dhe kështu tregon kuptimin »e guximtarit«, ose shkurtësë e emrit grek »Theódoros, Theodótos«. Nga ky apostull kemi shumë pak të dhëna. Sipas Gjonit Ungjilltar, në darkën e fundit ishte ai i cili i shtroi pyetje Jezu Krishtit: *"Zotëri, ç'ndodhi që do të na dëftobesh neve e jo botës"* (Gjn 14, 22). Kjo është një pyetje e cila është shumë aktuale, të cilën kishim për t'a shtruar edhe ne Zotit: Përse i ringjalluri nuk lajmërohet përherë për të treguar fuqinë e tij dhe se ai është fitues? Përse ai ju është lajmëruar vetëm nxënësve të tij? Përgjigja e Jezusit është shumë misterioze dhe e thellë: *"Nëse ndokush më do, ai do të ma mbajë fjalën, Ati im do ta dojë, tek ai do të vijmë dhe tek ai do të banojmë."* (Gjn 14, 23). Kjo dëshiron të na thotë, se të ringjallurin duhet parë dhe duhet pranuar me zemër, që kështu Hyji të banoi në ne. Ai dëshiron të hynë në jetën tonë dhe për këtë arsye lajmërimi i tij është një lajmërim i cili hynë dhe mbyllet në zemrat e tona të cilat janë të hapura për të. Vetëm në këtë mënyrë mund ta shohim të Ringjallurin.

Juda Tadeu është autor i një letre të Besëlidhjes së Re, e cila hyn në të ashtu quajturat »letrat katolike«, sepse nuk është e drejtuar vetëm një bashkësi të caktuar lokale por është e drejtuar një rrethi më të gjerë. Ajo u drejtohet të grishurve të dashur për Hyjit Atë dhe të ruajturve prej Jezu Krishtin« (Krah Jud 1). Kujdesi kryesor i kësaj shkrese është që të krishterët ti bëjë të

“ Por, ju të dashur, ndërtoni veten mbi themelimin e fesë suaj tejet të shenjtë duke u lutur në Shpirtin Shenjt. Qëndroni në dashurinë e Hyjit duke pritur mëshirën e Zotit tonë Jezu Krishtit për jetën e pasosur. Disa – të ndër dyshimtë - qortoni« (Jud 20–22). ”



kudjesshëm që ta pranojnë hyrin e Hyjit dhe të ruhen prej ëndërruesve të cilët e përbuzin Madhërinë dhe e shajnë lavdinë e Hyjit (Krah. Jud 8). Ai i quan ata të mjerë dhe me falë të rreptat thotë: *"ecin udhës së Kainit"* (Jud 11). Po ashtu i krahason me *"retë pa ujë... që erërat i sjellin këndej e andej; lëndë të pafrytshme të vjeshtës në mbarim, dy herë të thata, të nxjerra me rrënjë, valë të tërbuara të detit që bëjnë të shkumiten turpësitë e veta, yje të shkëputura, endacake, për të cilat ruhet terri i errësirës së përjetshme"* (Jud 12–13).

Në këtë letër lexojmë edhe

qortime: *"Por, ju të dashur, ndërtoni veten mbi themelimin e fesë suaj tejet të shenjtë duke u lutur në Shpirtin Shenjt. Qëndroni në dashurinë e Hyjit duke pritur mëshirën e Zotit tonë Jezu Krishtit për jetën e pasosur. Disa – të ndër dyshimtë - qortoni"* (Jud 20–22). Letra përfundon me këto fjalë të mrekullueshme: *"Atij që mund t'ju ruajë të mos bini në mëkat dhe t'ju paraqesë të patëmetë me hare para Lavdisë së vet - Një të vetmit Hyj, Shëlbuesit tonë, nëpër Jezu Krishtin, Zotin tonë: lavdi, madhëri, fuqi dhe pushtet para çdo kobe, tani dhe në të gjithë shekujt. Amen"* (Jud 24–25).

Këtu shihet qartë se autori i këtyre rreshtave ka jetuar në plotësimin e plotë të besimit për të cilin besimi ishte e vërteta më e madhe siç është integriteti moral dhe gëzimi, besimi dhe lavdia dhe gjitha këto bazën e kanë në mirësinë e Hyjit tonë dhe në mëshirën e Zotit tonë Jezu Krishtit. Për këtë arsye mund të na ndihmojnë Simonit Kananeu dhe Juda Tadeu që përherë ta zbulojmë bukurinë e besimit të krishterë dhe që të jetojmë të pa lodhur duke e dëshmuar Jezu Krishtin me jetë dhe me vepra.

Heshtja e Shën Jozefit kundër “zhurmës së tepërt” të botës: Shën Jozefi në Magjisterin papnor

■ SHKRUAN:
Atë Bernard Caruana O.P.

Papët nuk janë të fundit që këndojnë lavdinë e Sh. Jozefit! Nga Piu IX te Gjon Pali II, duke kaluar nëpërmjet Gjon XXIII sa familjaritet rreth imtimitetit të raportit të tyre me mbrojtësin e Kishës universale! Piu IX. Me dekretin e Kongregatës së Shenjtë të Riteve *Quemadmodum Deus* (8 dhjetor 1870) shpall Sh. Jozefin pajtor të Kishës universale. Jozefi i Egjiptit tregohet si Sh. Jozefi i Nazaretit. Vetëm Sh. Jozefi është i dyti pas Marisë në pushtetin e ndërmjetësimit. Me dekretin *Indytm Patriarcham* (7 korrik 1871) i njihet Sh. Jozefit e drejta e një kulti më të madh se të gjithë shenjtërit e tjerë, atij iu dhanë hire të veçanta për statusin e tij.

Luani XIII. Në enciklikën *Quamquam pluries* (15 gusht 1889) paraqet të gjithë doktrinën rreth Sh. Jozefit, nga themelet e dinjitetit dhe lavdisë së tij, deri në arsyen e vetme për të cilën meritonte të shpallej pajtor i të gjithë Kishës, model dhe avokat i të gjitha familjeve të krishtera. Me Letrën apostolike *Neminem fugit* (14 qershor 1892) pohon pjesëmarrjen intime të Sh. Jozefit në dinjitetin supreme të Familjes së Shenjtë.

Benedikti XV. Në Motu proprio *Bonum sane* (25 korrik 1920), të shkruar me rastin e 50^ë vjetorit të shpalljes së Sh. Jozefit pajtor të Kishës kujton nevojën dhe efektin e devotshmërisë së drejtuar atij, si zgjedhje e problemeve të pasluftës dhe propozon virtytet e tij në mënyrë të veçantë për të varfërit e tij në mënyrë të veçantë për të varfërit dhe punëtorët.

Piu XI. Në fjalimin e 21 prill 1926 mëson sesi titulli i pajtorit të Kishës i përkiste Sh. Jozefit që nga koha kur ishte Kryetar i Familjes së Shenjtë. Në fjalimin e 19 mars 1928 mbështet superioritetin e Sh. Jozefit me Bashkimin Ipostatik nga e cila rrjedh pushteti i tij i ndërmjetësimit. Në Enciklikën *Divini Redemptoris* të 19 mars 1937 e propozon Sh. Jozefin si model dhe pajtor të punëtorëve përballë komunizmit. Në fjalimin e 19 mars 1938 i shton ndërmjetësimit të Sh. Jozefit titullin e “gjithëpushtetshëm”.

Piu XII. Në fjalimin e 1 maj 1955 e ripropozon Sh. Jozefin si pajtor dhe model i punëtorëve dhe themeloni festën e Sh. Jozefit punëtor. Në radiomesazhin e 19

shkurt 1958 nxënëseve të shkollave katolike amerikane ngulit devotshmërinë ndaj Sh. Jozefit, përshkruan rolin, shenjtërinë dhe personalitetin.

Gjoni XXIII. Në Letrën apostolike të 19 mars 1961 përmbledh aktet e papëve paraardhës në nder të Sh. Jozefit dhe e emëron pajtor qiellor të Koncilit Vatikani II.

Pasi, si Maria që vazhdon, në gjirin e Kishës, ministrin e saj amënor të krijimit të Njeriut të ri, kështu Sh. Jozefi vazhdon të vigjilojë mbi rritjen e Trupit Mistik të Atij mbi të cilin ka marrë autoritetin atëror. Në këtë shekull, ku shoqëria jonë perëndimore përjeton një krizë atësie që shkund deri edhe themelet e shoqërisë sonë, kur psikologë, sociologë, kërkojnë modele të reja baballarësh, ndoshta duhet ta drejtojmë shikimin dhe zemrat tona drejt atij që e ka mishëruar, në zemër të botës, atë atësi hyjnorë “nga e cila çdo atësi në qiell e në tokë merr emrin” (Ef 3, 15). Përse të mos ndjekim shembullin e “papës së mirë Gjoni XXIII” që rrefen me shumë thjeshtësi: “Sh. Jozefin, unë e dua shumë, deri në atë pikë sa që nuk mund ta filloj ditën time, as ta përfundoj, pa qenë fjala ime e parë dhe mendimi im i fundit për të”.

Edhe Pali VI ka folur shpesh për sh. Jozefin, jo shumë për të vënë në pah cilësitë e tij, por për të kujtuar misionin e tij në Kishën e sotme: “Misioni i Jozefit ndaj Jezusit dhe Marisë që një mision mbrojtës, ruajtjeje dhe mbështetjeje (...). Kisha ka nevojë të jetë e mbrojtur; ka nevojë të jetë e ruajtur, në shkollën e Nazaretit, e varfër dhe punëtor, por e gjallë, e ndërgjegjshme dhe e gatshme për misionin e saj mesianik. Misioni i Sh. Jozefit është i yni: të ruajmë Krishtin dhe ta bëjmë të rritet në ne dhe përreth nesh”. (Angelus, 19 mars 1970).

Gjatë lutjes *Angelus* në vitin e parë të pontifikatit të tij, Benedikti i XVI vë në dukje që në një botë “tepër të zhurmshme, që nuk favorizon qetësinë dhe dëgjimin e zërit të Hyjit”, të krishterët duhet “të lihen të “infektohen” nga heshtja e shën Jozefit”. Benedikti i XVI kthehet mbi mënyrën më të vërtetë për t’u përgatitur për Krishtlindje dhe propozon heshtjen, lutjen, soditjen “për të mbajtur Jezusin në jetën tonë” dhe e bën duke treguar figurën e shën Jozefit, atë të babait kujdestar të Jezusit. Papa kujton që Gjon Pali II ishte shumë i devotshëm ndaj tij dhe i ka kushtuar këtij shenjtë

Nxijtjen apostolike *Redemptoris Custos*. Rreth figurës së shën Jozefit është bërë shumë ironi nga jo të krishterët; ndër katolikët lavdërohet vetëm funksioni i tij “ligjor” – për ta bërë Jezusin “bir i Davidit” – dhe si mbështetje ekonomike të Familjes së shenjtë.

Benedikti XVI nënvizon një funksion tjetër, edhe teologjike dhe njerëzore të këtij shenjtë. “Nuk egzazjerohet – ka thënë papa – që pikërisht nga “babai” Jozef, Jezusi të ketë marrë – në planin njerëzor – atë brendësi të fortë që është kusht i drejtësisë të vërtetë, “drejtësisë më të lartë”, që Ai një ditë do t’u mësojë dishepujve të tij”. (Angelus, 18 dhjetor 2005).

Nxijtja apostolike “Redemptoris Custos”

Të themi menjëherë që e reja e Nxijtjes apostolike qëndron në faktin që ka vënë në vend të parë atësinë e shën Jozefit dhe rolin e tij si “ministr i shpëtimit” (n.8). Martesa me Marinë normalisht nuk e humbet rëndësinë e saj, por i nënshtrohet asaj dhe i finalizohet. “Hyji e zgjedh Jozefin si të fejuarin e Marisë për të siguruar mbrojtjen atërore Jezusit” (n.7).

Duke mbetur koherente me fillimin e Nxijtjes apostolike *Redemptoris Custos*, Gjon Pali II vë në pah që “bërthama qëndrore të së vërtetës biblike rreth shën Jozefit, momenti i ekzistencës së të cilit i referohen Eftërit e Kishës, gjendet në fjalët: “Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë, të fejuarën tënde, sepse foshnja që është zënë në të, i zu për virtyt të Shpirtit Shenjt. Ajo do të lindë djalë e ti ngjitja emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbtojë popullin e vet prej mëkateve të tij”. (Mt 1, 20-21) (n.2). “Dhe kur Biri i mbajtur në krahë nga Maria, do të lindë, do të quhet Jezus. Ky ishte një emër i njohur mes izraelitëve dhe ndonjëherë u vihej bijve. Në këtë rast, ama, bëhet fjalë për Birin që – sipas premtimit hyjnor – do të përmbushë plotësisht domethënien e këtij emri: Jezus-Yehosua, që do të thotë: Hyji shpëton. Mesazhi i drejtohet Jozefit si “i Fejuari i Marisë”, atij që në kohën e duhur duhet t’i vendoste emrin Birit që do të lindte nga Virgjëra e Nazaretit, e martuar me të. Pra, i drejtohej Jozefit duke i besuar detyrën e një babai tokësor ndaj Birit të Marisë.” (n.3).

Këto detyra përshkruhen me imtësi, duke vënë në dukje domethënien e tyre dhe vlerën shëlbimprurëse, nga momenti që



“Me mishërimin “premtimet” dhe “figurat” e Besëlidhjes së Vjetër bëhen “realitet”: vende, persona, ngjarje dhe rite gërshetohen sipas urdhrave të saktë hyjnor, të transmetuar me anë të ministrit engjëllor dhe të marrë nga krijesat veçanërisht të ndjeshme ndaj zërit të Hyjit.”

“ruajtjes së kujdesshme të shën Jozefit i besohen fillimet e shëlbimit tonë; siç pranon liturgjia (nr. 8). Bëhet fjalë për një “shërbim” që i përket drejtpërdrejt personit dhe misionit të Jezusit, sa ta përkufizojë shën Jozefin “ministr shpëtimit”, cilësi që na fut në temën e pjesëmarrjes së shën Jozefit në urdhrin e bashkimit ipostatik.

Pas enciklikave *Redemptor hominis*, *Dives in misericordia*, *Dominum et vivificantem* dhe *Redemptoris Mater* – të kushtuara përkatësisht Fjalës së mishëruar, Hyjit Atë, Shpirtit Shenjt dhe të Lumës Virgjëres Mari, - në ve-

prën magjistrale të Papës Gjon Pali II nuk mund të mungonte një dokument rreth shën Jozefit, fillimi i të cilit tingëllon pikërisht *Redemptoris Custos*. Brenda kësaj “pentalogjie” ideale, nxitja apostolike jozefine i afrohet në mënyrë të veçantë enciklikave *Redemptor hominis* dhe *Redemptoris Mater*, ku theksi vendoset, së bashku, mbi misterin e mishërimit dhe mbi atë të Shëlbimit, një theksim që reflekton në mënyrë të përkryer temat zotëruese të Papës Gjon Pali II, domethënë Krishti dhe njeriu.

Në perspektivën e një ungjillizimi të madh dhe rrënjësor,

që duhet të jetë para së gjithash një ungjillizim i ri, Ati i Shenjtë propozon sërish themelet e fesë në mënyrë organike dhe sistematike duke u nisur nga thellësitë e misterit të Hyjit: para së gjithash misteri “i nevojshëm”, Trinia; pra misteri “i lirë”, ai i ekonomisë të zgjedhur në mënyrë të lirë nga Hyji për të shpëtuar njeriun, mishërimi, mundimet, vdekja dhe ngjallja e Shëlbuesit. Pika e bashkimit e dy mistereve, pika “e rëndësishme”, është Jezu Krishti në të cilin Hyji zbulon së bashku vetveten dhe vullnetin e tij të shpëtimit dhe që nuk mund të ndahet nga ata që kanë qenë, me liri por me zgjedhje hyjnore arbitrare, të përfshirë imtësisht dhe në mënyrë të pandashme në “ardhjen e tij në mish” (6).

Procedura është rreptsisht teologjike por që pranon të bëhet edhe meditim në nderim të filimit që mëshira duhet të jetë teologjike dhe teologjia duhet të komunikojë të vërtetën të gjalla dhe gjallëruese.

Kështu, pasi kemi kujtuar njëqind vjetorin e dokumentit kryesor paraardhës të Magjisterit rreth Shën Jozefit, enciklika *Quamquam pluries* të Papës Luani XIII – njëqind vjetor që përbën rastin e ardhshëm të nxitjes apostolike *Redemptoris Custos* -, dhe që “plani hyjnor [...] e ka themelin e tij në misterin e mishërimit” (nr. 1), Papa Gjon Pali II bën skicën, mbi këtë themel, e linjave të një “teologjie të shën Jozefit”. Pikënisja është një pjesë Ungjilli sipas shën Mateut: “Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë të marrësh Marinë, të fejuarën tënde, sepse foshnja që është zënë në të, u zu për virtyt të Shpirtit të Shenjtë. Ajo do të lindë një djalë e ti ngjijta emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbtojë popullin e vet prej mëkateve të tij”. [...] Jozefi, si u zgjua nga gjumi, bëri siç i urdhëroi engjëlli i Zotit: e mori në shtëpi të fejuarën e vet.”

Në këto fjalë Papa sheh “një analogji të ngushtë” (nr. 3) me lajmërimin e Marisë. Ashtu si për Marinë, në përgjigjen bujare këtij lajmërimi qëndron në madhësinë e vërtetë të shën Jozefit: ashtu si Maria që është e madhe sepse ka ngjizur Fjalën “përpara me mendje sesa me trup”, kështu “drejtësia” e Jozefit qëndron e gjitha në bindjen e tij fjalëve të Zotit, shprehje e kulluar e “bindjes së fesë”. “Për të vërtetë, Jozefi nuk iu përgjigj ‘lajmërimit’ të engjëllit si Maria, por ‘bëri siç i urdhëroi engjëlli i Zotit: e mori në shtëpi të fejuarën e vet.’ Ajo që ai bëri është e kulluar ‘bindje në fe’ (krr Rm 1, 5; 16, 26; 2 Kor 10, 5-6).

“Mund të thuhet që ajo që shën Jozefi bëri, e bashkoi në mënyrë krejtësisht të veçantë me fenë e Marisë: ai pranoi si të vërtetë të vjen nga Hyji atë që ai kishte pranuar që nga lajmërimi. Konkili mëson: ‘Hyjit që zbulon i duhet dhënë ‘bindja e fesë’, për të cilën njeriu braktiset plotësisht dhe lirisht në Hyjt, duke i dhënë bua ‘nderimit e plotë të intelektit dhe të vullnetit’ dhe miratuar në mënyrë

të vullnetshme zbulimit të bërë nga ai” (Kusht. Dogm. Rreth Zbulimit hyjnor *Dei Verbum*, 5). Fjalja e sipërcituar, që prek thelbin e vetë fesë, i aplikohet në mënyrë të përkryer Jozefit nga Nazareti” (nr. 4).

Ajo që Jozefi bëri është e përbledhur në shumë episodi, në një moment pa domethënie, që vetëm një ekzegjezë thellësisht teologjike, “e dijes”, në shkollën e etërve, mund ta kuptojë në tërë rëndësinë e saj. Edhe këtu, si në enciklikën *Redemptoris Mater*, mësimi është edhe rreth metodës, sesi të lexohet Fjala e shënjtë e Hyjit e shkruar, sepse direktivat e Konkilit Ekumenik Vatikani II rreth rëndësisë që duhet t’i jepet Shpëritit të Shenjtë të mos çojë në një biblicizëm jo të shëndoshë. Në Ungjijtë është paraqitur më qartësi detyra atërore e Jozefit ndaj Jezusit. Në fakt, shpëtimi, që kalon nëpërmjet njerëzimit të Jezusit, realizohet në gjetet që bëjnë pjesë në të përditshmen e jetës familjare, duke respektuar atë “mirëdashje” që i përket ekonomisë së mishërimit. Ungjilltarët janë shumë të kujdesshëm të tregojnë sesi në jetën e Jezusit asgjë nuk i lihet rastit, por gjithçka është zhvilluar sipas një plani hyjnor të vendosur. Formula e përsëritur shpesh: “Kështu ndodhi, që të përbusheshin...” dhe riferimenti i ngjarjes të përshkruar në Besëlidhjen e Vjetër mundohen të vënë në dukje bashkimi dhe vazhdimësinë e projektit, që në Krishtin arrin përmbushjen e tij.

“Me mishërimin ‘premtim’ dhe ‘figurat’ e Besëlidhjes së Vjetër bëhen ‘realitet’: vende, persona, ngjarje dhe rite gërsëtohen sipas urdhrave të saktë hyjnor, të transformuar me anë të ministrit engjëllor dhe të marrë nga krijesat veçanërisht të ndjeshme ndaj zërit të Hyjit” (nr. 8).

“Misteri” i shën Jozefit është i përbledhur i tëri në paradoksin e të vërtetës absolute të martesës me Marinë dhe të atësisë nga një anë me Jezusin dhe të ngjizjen virgjërore të Birit të Hyjit për virtyt të Shpirtit të Shenjtë nga ana tjetër. Janë dy unazat e zinxhirit që nuk është e drejtë të lihet nëse nuk do që të humbësit misterit. Me siguri, atësia “ligjore” kishte për hebrejtë një rëndësi që sot është e vështirë të kuptohet. Nuk duhet të harrohet që genealogjia e Mateut dhe e Lukës, që vërtetojnë prejardhjen nga Davidi e Jezusit dhe pra ligjëshmërinë e pretendimit mesianik, kalojnë nëpërmjet Jozefit, edhe pse vëhet në dukje që atësia e tij nuk është fizike. Kështu edhe vendosja e emrit e shën në një rol tipik atëror, një rol me vlerë shumë të lartë në botën biblike dhe tradicionale në përgjithësi. Por atësia e Jozefit ka një themel të vërtetë akoma më të lartë. Ka marrë këtë mision nga Hyji dhe Hyji, në momentin në të cilin i beson një mision, krijon të gjitha kushtet objektive për përmbushjen e tij.

“Dysimi” i Jozefit përbën një nga temat klasike të Josepho-



“Misioni i Jozefit ndaj Jezusit dhe Marisë që një mision mbrojtës, ruajtjeje dhe mbështetjeje (...). Kisha ka nevojë të jetë e mbrojtur; ka nevojë të jetë e ruajtur, në shkollën e Nazaretit, e varfër dhe punëtore, por e gjallë, e ndërgjegjshme dhe e gatshme për misionin e saj mesianik. Misioni i Sh. Jozefit është i yni: të ruajmë Krishtin dhe ta bëjmë të rritet në ne dhe përreth nesh” (Papa Pali VI).

logia, reflektimi teologjik rreth “misterit” të shën Jozefit ngre lart mbi të gjitha, shtytjen e devotshmërisë popullore dhe për impuls të Magjisterit, si dishiplinë e paruar, sa mund të jetë natyrisht një degë e teologjisë, që është në mënyrë specifike një: përballë atësisë së Marisë, shkak i së cilës nuk është, shenjtë mbetet i turbulluar, sa të vendosë në zemër të tij laleshjohë të fejuarën.

Dokumenti, siç është normale, nuk hyn në diskutimin teologjik, megjithatë vë në dukje që turbullimi paralajmëron pranimin e përvahtuar dhe bujar të një misioni të marrë nga Hyji. Sipas opinionit më të ndjekur sot nga specialistët e teologjisë jozefine, turbullimi i Jozefit është ai i njeriut të drejtë që, në prag të një misterit më të madh se ai, për të cilin rezultojnë shumë e vështirë të mendohet që nuk dihet që më parë, nuk di të vendosë para se të kuptojë vullnetin e Hyjit. Por një herë që dëgjon “thirrjen”, e drejton jetën e tij si shenjë të besnikërisë, në heshtje, por e qëndrueshme, model i kulluar i bindjes në fe.

E vërteta e martesës dhe e atësisë së Jozefit kanë pasojë shumë të rëndësishme për teologjinë e martesës dhe të dashurisë në përgjithësi. Vënë në dukje një

fakt kryesor. Martesa – dhe dashuria mes një burri dhe një gruaje – nuk qëndron në seksualitet, pa i hequr asgjë rëndësisë dhe shënjtërisë së seksualitetit mes bashkëshortëve. Një konsideratë minimalistike dhe kryesisht falso – sepse në kundërshtim me Shkrimin e Shenjtë – të martesës së Jozefit ka shoqëruar teorinë e raportit seksual si element thelbësor të martesës, ndërsa është edhe reflektimi rreth kësaj pike të misterit të krishterë ta drejtojë traditën më të mirë teologjike të shohë si elementin formal të martesës në “bashkim i pandashëm i shpirtit” (15). Edhe nga ky këndvështrim misterin në heshtje i Jozefit është veçanërisht kuptimplotë për epokën tonë, e sëmure nga ipertrofia e seksit.

Si për Marinë, ashtu edhe për Jozefin misioni i marrë nga Hyji nuk përfundon me “shtegtimin e fesë” tokësore, por vazhdon në qiell. Edhe këtu vlen i njëjti princip: sa është në raport me Kryetarin është në raport me Trupin dhe me gjymtyrët e tij. Bëhet fjalë për një princip që, në këtë rast, dyfishohet me raportin e veçantë që lidh shën Jozefin me të Lu-men Virgjër Mari. Ja pse, “duke iu frymëzuar Ungjillit, Elërit e Kishës që nga shekujt e parë kanë vënë në

dukje që shën Jozefi, ashtu siç pati kujdes të përzemërt për Marinë dhe iu kushtua me angazhim të gëzueshëm edukimit të Jezu Krishtit, kështu ruan dhe mbron trupin e tij mistik. Kishën, që Virgjëra Mari është figurë dhe model i saj.” (nr. 1); dhe Piu IX ka sanksionuar sa ins-tinkti i fesë së popullit të krishterë ka kuptuar dhe jetuar gjithmonë, duke e shpallur “Pajtorin e Kishës katolike”.

Papa Gjon Pali II kujton, përkundrazi, me nderim të veçantë lutjen që Luani XIII kishte vendosur në fund të enciklikës së tij, lutje që tashmë ka hyrë plotësisht në pasurinë e devotshmërive më të dashura për popullin e krishterë. Në të i kërkohej Shën Jozefit që ta vazhdojë misionin e tij si mbrojtës, duke larguar nga ne “këtë murtajë gabimesh dhe të vësesh”, duke na mbështetur “në këtë luftë me pushtetin e errësirave”, duke na mbrojtur “nga kurtëthet armiqësore dhe nga çdo kundërsht”. “Akoma sot – na siguron Ati i Shenjtë, i përzemërt kujtimi i tij – kemi arsye të shumta për t’u lutur në të njëjtën mënyrë (...). akoma sot kemi arsye të qëndrueshme për t’i porositur shën Jozefit çdo njeri” (nr. 31).

Prania e rregulltarëve në Kishën dhe në

■ SHKRUAN:

Don Anton UKAJ

Jam i vetëdijshëm se tema të cilën po e trajtojme, kërkon një vështrim shumë më të gjerë dhe më të kujdesshëm, por qëllimi është që të bëjmë një paraqitje sadopak të shkurtër për të njoftuar lexuesin për praninë dhe për punën e rregulltarëve në shoqërinë tonë.

Rregulli Françeskan – françeskanët

Rregulli Françeskan është një vëllazëri rregulltare ndërkombëtare brenda Kishës Katolike, të së drejtës papnore, njëkohësisht aktive dhe kontemplative, e cila përpjet që ta jetojë në mënyrë sa më autentike Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit në rrethanat konkrete të botës së sotme.

Shën Françesku i Asizit në vitin 1209 pikërisht në vendlindjen e tij, pra në Asizi të Italisë, themeloi Rregullin Françeskan dhe menjëherë këtij njeriu të jashtëzakonshëm iu bashkëngjitën freret e parë. Në vitin 1209 papa Inocenti i III gojarihet e miratoi dhe e bekoj Rregullin e ri Françeskan. Ndërsa, në vitin 1223 papa Honori i III-të edhe me shkrim, zyrtarisht e miraton Rregullin Françeskan.

Në një kohë shumë të shkurtër dhe shumë të shpejtë fama e veprimtarisë dhe e karizmës françeskane përhapej në shumë vende të tjera të Evropës, sa që shumë djem dhe vajza, burra dhe gra vendosën ta përqafojnë me jetën e tyre "Rregullin Françeskan".

Karizma specifike e Rregullit Françeskan është: të jetojnë Ungjillin e Zotit tonë Jezu Krishtit në varfëri, dëgjese dhe pastërti; nderimi i Krishtit Zot e njeri në natyrën e tij njerëzore – që nga mishërimi dhe lindja, e deri te kryqëzimi, vdekja dhe varrimi i tij; promovimi i paqes dhe i mirëkuptimit me të gjithë njerëzit si dhe respektimi, mbrojtja dhe ruajtja e të gjitha krijesave të Zotit.

Siç dihet familja e madhe françeskane përbëhet dhe ndahet në shumë degë:

1) Rregulli i parë Françeskan, dega mashkullore, ku vendore, e cila prapë ndahet në tri degë të tjera: Rregulli Françeskan apo Rregulli Vëllezërve të Vegjël

me më shumë se 15.137 anëtarë; Rregulli Françeskan Kapuçin me më shumë se 11.340 anëtarë dhe Rregulli Françeskan Konventual me më shumë se 4.464 anëtarë.

2) Rregulli i Dytë Françeskan (motrat e Shën Klarës së Asizit, „Klarisat“ – dega femërore, kontemplative) me më shumë se 22.000 anëtarë.

3) Rregulli i Tretë Françeskan (kuvendor dhe shekullar; mashkullor dhe femëror). Edhe Rregulli i Tretë Françeskan është ndarë në shumë kongregata, prej të cilave duhet të dallojmë veçanërisht:

a) Rregullin e Tretë Françeskan – dega mashkullore, kuvendore, me më shumë se 5.000 anëtarë.

b) Mbi 400 kongregata të ndryshme të motrave françeskane (kuvendore) – me rreth 200.000 anëtare.

c) Rregullin Françeskan Shekullar – njerëz shekullarë, burra e gra, familjarë; por në këtë rregull ka edhe shumë meshtarë shekullarë dhe ipeshkvij. Kanë rreth 1.500.000 anëtarë.

Prej këtyre bashkësive në Kishën tonë lokale të Kosovës veprojnë: Rregulli i parë Françeskan me qendër në Gjakovë; dy kongregata të Rregullit të Tretë Françeskan: Motrat e Mëshirshme të Shën Kryqit – në katër shtëpi: Prishtinë, Janjevë dhe Gjakovë si dhe Motrat Françeskane të Zojës së Papërlyer – në gjashtë shtëpi: Velezhë, Zym, Budisalc, Novo Sellë, Pjetërshah dhe Prizren.

Veprimtaria e françeskanëve në Kosovë

Nga dokumente të ndryshme historike dhe arkivore na bëhet e ditur se freret kanë vepruar në Kosovë edhe para pushtimit otoman. Për kontributin e madh dhe shumë të çmueshëm të frerëve në Kishën tonë lokale, gjejmë të dhëna edhe në historinë e Ipeshkvisë Shkup-Prizren, ku thuhet se për disa herë më radhë kjo Kishë është udhëhequr pikërisht nga rregulltarët (ipeshkvij) françeskan si p.sh. Mons. Fridericus de Rotersbecke (1351), Mons. Antonius de Teramo (1690), P. Daniel Duranti, (1702), Mons. Darius Bucciarelli, po ashtu ipeshkvj françeskan (1864-1878), i cili e ka ndërtuar Katedralen e Prizrenit, që është funksionale edhe sot. Françeskan ishte edhe famullitari i Letnicës, P. Anto

Marojević, i cili e bashkë-ndau fatin e martirëve të Stubllës (1846-1848). Freret, përpos lëmit fetar, ata shquhen edhe për kontributin e tyre të pazëvendësueshëm në lëmin kombëtar dhe kulturor.

Misionarët françeskanë në kohërat më të vështira të sundimit otoman, e sidomos prej vitit 1636 veprojnë anëmbanë Kosovës. Deri në vitin 1958 kanë mbajtur famullitë: Pejë, Zllakuqan, Gllogan dhe Zym, si edhe shenjtëroren e Shën Antonit të Padovës në Gjakovë.

Nga viti 1958 e kanë vetëm famullinë e Gjakovës, së bashku me shenjtëroren e Shën Antonit.

Prania dhe misioni ungjilëzues i frerëve në Ipeshkëvin tonë çmohet lartë si nga klerikët, ashtu edhe nga besimtarët tanë, për çka duhet falënderuar Zotin dhe lypset përkrahur që të vazhdojnë të punojnë në shembullin e të parëve të tyre për të mirën e Kishës dhe të kombit.

'Miqte e Jezusit' – jezuitët

"Zoti në mësinë dhe dashurinë e tij të pafund ka dëshiruar të na bashkojë ne, kështu të ligsh të me prejardhje nga vende dhe kultura të ndryshme". Kështu shprehej, në vitin 1539, grupi i parë i jezuitëve në momentin e vendosjes nëse të fillohet apo jo një bashkësi e rregulltare brenda Kishës Katolike. Dhe ja njëti i cili bashkohet menjëherë në zemrën e atij grupi: "për sa i përket anës sonë nuk duhet ta thejme këtë bashkim dhe bashkësi të dëshiruar nga vetë Zoti; përkundrazi duhet ta mbajmë të shëndoshtë dhe ta forcojmë, duke u bashkuar në një trup të vetëm, të kujdesshëm dhe të gatshëm njëri për tjetrin, në shikim të së mirës më të madhe për shpirtin. Vlera e shumë të bashkuarve sigurohet se do të vlejë më shumë dhe do të jetë më e qëndrueshme, për të arritur qëllime rezultati, se sa të shpërndahet në shumë drejtime".

Duke e rishikuar historinë e këtyre jezuitëve të parë del në pah intervenimi i urtë i Zotit, që ka bërë të takojë Injacin dhe nëntë miqtë e parë të tij. Këta, që vetë Injaci i ka definuar 'Miqte e Zotërisë' bashkërisht kanë zbuluar një frymëzim dhe një afërsi shpirtërore. Përveç kësaj, të gjithë këta kanë kaluar përmes përvojës së Ushtrimeve Shpirtërore, kështu që mënyra e të jetuarit e jezuitëve, gjen pikë-

Kisha Françeskane, Gjakovë



risht në Ushtrimet Shpirtërore të Injacit të Loyolës vendin, në të cilin rinjohin rrënjët e veta.

Lirisht mund të thuhet se Injaci i Loyolës dhe miqtë e tij formuan një grup apostolik të bazuar në dashuri, që mori emrin 'Shoqëria e Jezusit'. Dhe pastaj nga këtu ka lindur emërtimi: 'Jezuitët'.

Pasi që bënë kushtin e pastërtisë, dëgjësës dhe varfërisë dhe u shuguruan meshtar, 'Miqte e Parë' ja dhuruan vetveten Zotit për të punuar në emër të kryqit të Krishtit dhe për të shërbyer vetëm Zotin dhe Kishën.

Nën dëgjësën e Papës, kanë qenë të dërguar në tërë botën për mbrojtjen dhe shpalljen e fesë dhe për rritjen e shpirtit në jetën dhe në doktrinën e krishterë.

Kështu zë fille jeta apo bashkësia e parë e Jezuitëve. Në një kohë shumë të shpejtë angazhimi dhe misioni i Jezuitëve arriti në vende të ndryshme të botës për tua shpallur Lajmin e Gëzueshëm njerëzve që në të

shumtën e rasteve as që kishin dëgjuar ndonjëherë për Jezu Krishtin. Misionaret Jezuitë veprojnë anëmbanë botës, ashtu siç bënte edhe themeluesi i tyre Shën Injaci i Loyolës, gjithmonë të gatshëm për të udhëtuar deri në skaje të globit atje ku nevojat mund të jenë më të mëdha.

Përcjellja shpirtërore, predikimi i Lajmit të Gëzueshëm, formimi kulturor nëpërmjet shtypit dhe institucioneve të ndryshme kulturore dhe formuese e karakterizojnë jetën dhe veprën e Jezuitëve kudo që janë nëpër vende të ndryshme të botës.

Për sa i përket numrit të jezuitëve, viteve të fundit ka pas një rënie të dukshme, ashtu siç ka ndodhë në përgjithësi me thirrje të shenjta. Nga afër 36.000 jezuitë të viteve 60-ta, sot numërohen rreth 21.000, nga të cilët 3.600 në Shtetet e Bashkuara, 3.800 në Indi, 2.100 në Amerikën Latine dhe 6.400 në Evropë. Kjo rënie numerik përbën njërin ndër problemet krye-

... dhe kontributi i tyre ë shoqërinë tonë



sore të 'Shoqërisë së Krishtit' në kryerjen e misionit të tyre.

Veprimtaria e jezuitëve në trojet shqiptare

Fillimi i pranisë së jezuitëve në tokën shqiptare i përket vitit 1841 me disa Etër që vinin nga Sicilia (Itali), kur Shqipëria ishte ende nën Perandorinë Turke dhe nuk kishte kufijtë që ka sot. Ungjillëzimi nuk ishte aspak i lehtë, sepse i duhej të përballej me kundërshtime të shumta dhe të forta.

Jezuitet kontribut të veçantë kanë dhënë përmes shkollave, kolegeve, seminarëve dhe bibliotekave. Krahas këtyre veprave u zhvillua një punë e dendur misionare, kulturore, fetare dhe artistike, me grupe muzikore dhe teatrale, me revista dhe me shtypshkronjën „Zoja e Papërlyer“.

Veprat që ka lënë më shumë jehonë, sidomos në malësi, kanë qenë „misionet shëtitëse“ (1886) (Missione Volante), të cilët kishin një ritëm pune pak paradoksal. Gjatë dimrit, kur njerëzit qëndronin më shumë në shtëpi, misionarët shkonin nga njëra shtëpi në tjetrën për ungjillëzimin dhe pajtimin e familjeve që ishin „në gjak“. Gjatë verës ktheheshin në bashkësi për të studiuar historinë dhe zakonet e shqiptarëve, të riorganizonin të dhënat shkencore që kishin mbledhur, të shkruanin relacione, të botonin libra dhe fjalorë. Misionet shtriheshin jo vetëm në Shqipërinë veriore por edhe në Kosovë në qytet Pejë, Prizren, Gjakovë, Janjevë,

Letnicë, Stubëll, Shkup etj. Etërit Jezuitë të gjitha këto vepërën në bënin nga qendra e tyre në Shkodër.

Edhe sot, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, është ruajtur në kujtesën popullore bagazhi i këngëve të thjeshta me tekste katekizmi të kompozuar nga etërit jezuitë. Por populli kujton sidomos shembullin e jetës së tyre me të vërtetë heroik, duke pësuar të ftohtin dhe duke fjetur shpesh edhe në tokë në familjet ku ishin të ftuar.

Regjimi i ri totalitar shqiptarj i instaluar në vitin 1946, përveç mbylljes së shkollave jezuitë dhe françeskanë dhe shkatërrimit të objekteve fetare, zhduk, pushkatoi, burgosi dhe torturoi klerikët dhe laikët e shquar e veçanërisht katolikët, të cilët u bënë fli e përndjekjeve të pamëshirë të një sistemi diktatorial. Pjesë e kësaj drame të paparë, ku ndera u pagua me gjak dhe djersa u kthye në gurë, kuptohet ishin edhe jezuitët dhe e gjithë ajo që ata kishin krijuar përgjatë një shekulli në trojet shqiptare. Fli e përgjakur e kohës u bënë Atë Daniel Dajani, Gjon Fausti, Gjon Pantalja etj. emrat e të cilëve i gjejmë në listën e 40 dëshmitarëve të fesë, të cilët kanë hyrë në proces drejtë lumturimit.

Pas demokratizimit të Shqipërisë në nëntor të vitit 1990 etërit jezuitë rifilluan ringjalljen e tyre. U kthyen dhe hapën objektet e mëparshme.

Prania e jezuitëve si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë është e një rëndësie të veçantë falë kontributit të tyre në fushat e

ndryshme edukative, kulturore dhe arsimore.

Kongregata Saleziane dhe karizma e sajë

Në momente dhe periudha të veçanta të historisë, Zoti zgjedh dhe dërgon njerëz të veçantë për të kryer, gjithashtu mision të veçantë në mesin e njerëzve.

Në fillim të shekullit XVIII-të, ku varfëria materiale, intelektuale dhe shpirtërore kishte arritur kulminacionin, në afërsi të Torinos të Italisë lind Gjon Bosko. Mësimi, shembulli dhe formimi që ai pranon si fëmijë nga nëna Margherita bëhen për të bazë e një edukimi të shëndoshë human dhe kristian. Inteligjenca, vullneti dhe shkathtësia e dallonin këtë djalosh të ri nga të gjithë bashkë-moshatarët e tij.

Pas formimit dhe edukimit të tij intelektual dhe shpirtëror që pranon në Seminar shugurohet për meshtar në vitin 1841 në Torino. Që në ditët e para të meshtarisë vërehej qartë se programi apo pasioni i tij ishte edukimi i të rinjve, i atyre më të varfërve dhe më të braktisurve.

Lojërat, aktivitetet, shëtitje dhe lutjet e përbashkëta të organizuara nga vetë ai bëhen pikë bashkimi dhe afrimi për të rinjtë e asaj kohe. Don Gjon Bosko duke e parë nevojën urgjente për të bashkuar dhe ndihmuar të rinjtë vendos të krijojë dhe ti japë jetë Oratorit të Shën Françeskut të Sales, nga rrjedhë edhe emri 'salezianët'.

Kongregata Saleziane e themeluar nga Shën Gjon Bosko dhe e frymëzuar nga mësimi dhe dashuria e Krishtit rritej dhe përhapej gjithnjë e më shumë, sa që sot veprojnë dhe punojnë në 127 vende të ndryshme të botës me më shumë se 16.645 salezianë në më shumë se 2.000 institucione të ndryshme kulturore dhe formative.

Edhe salezianët, ashtu sikurse edhe rregulltarët tjerë, bëjnë një jetë të kushtuar Zotit përmes kushtit të dëgjësë, varfërisë dhe pastërtisë. Tri kushtet janë shenja përmes së cilës rregulltarët vihen në shërbim të plotë të Zotit dhe të misionit të Tij për të realizuar paqen, drejtësinë dhe dashurinë mes njerëzve dhe një ditë jetën e pasosur.

Veprimtaria e salezianëve në Kosovë

Dashuria e Jezu Krishtit nuk njeh kufi. Kjo është vërtetuar më së miri nga jeta e atyre që për

arsye të Jezu Krishtit kanë thyer të gjitha barrierat gjeografike, ideologjike, klanore dhe fisnore e janë vendosur si shtegtarë nëpër rrugët e botës për të predikuar, dëshmuar dhe dhuruar të gjithëve dashurinë e Jezu Krishtit.

Salezianët për të parën herë arrijnë në Kosovë, saktësisht në Ferizaj, gjatë vitit 1938. Don Josip Radoha dhe don Franc Skuhala, nga Sllovenia, përveç se të kryenin obligimet që i takojnë një familje, ata duke e ndjekur karizmin e tyre, themeluan edhe Oratorin (Qendrën Rinore) ku organizonin shumë takime shpirtërore, kulturore dhe formative për të rinjtë e vendit. Në kujdes pastoral salezianëve, në vitin 1942, ju është besuar edhe familja e Janjevës, që në atë kohë ishte njëra ndër famullitë më të mëdha; ndërsa disa vite me vonë, me ardhjen e salezianëve tjerë, marrin në kujdes edhe Prishtinën dhe Peshterin që në atë kohë ishin nën mbikëqyrjen e meshtarëve që shërbenin në Janjevë. Në vitin 1958 Prishtina bëhet famulli në vete, por gjithnjë nën udhëheqjen e salezianëve, me famullitar: don Joze Bakan, pastai don Franc Skuhala, don Zef Gashi (aktualisht Arqipeshëv i Tivarit), don Nosh Gjollaj dhe don Lekë Oroshi.

Viteve të fundit salezianët kontribut të veçantë vazhdojnë të japin në fushën arsimore dhe kulturore, ku falë qendrave të tyre në Prishtinë dhe Gjilan, shumë njerëz kanë mundësi të përfitojnë atë çfarë edhe don Bosko dëshironte: një mendje më të ngritur dhe një shpirt më të mirë.

Qendra e Salezianëve në Prishtinë





Intervistë me dr. Pal Lekën, kryetar i komunës së Gjakovës

Korrupsioni është kanceri i një shoqërie

"Korrupsioni është kancer për një shoqëri. Nëse këtë dukuri, këtë kancer e zhdukim, Kosova do të ketë prosperitet. Por nëse ndodhë e kundërta ne do të mbesim këtu ke jemi, dhe larg do të jemi synimeve tona, për Bashkimin Evropian."

Drita: Si ishte jeta juaj dikur, cilat ishin vështirësitë e asaj kohe për një djalosh të ri?

Pal Lekë: Për sa i përket moshës time të re, si nxënës kam qenë i shkëlqyeshëm dhe çdo herë kam qenë në nivel të asaj që i është kërkuar një nxënësi filorist.

Po ashtu edhe në shkollë të mesme kam qenë nxënës i mirë, që ato kohëra e kanë karakterizuar edhe një gjendje të vështirë të qytetarëve në përgjithësi të popullit shqiptar, ka dashtë fati që ne të kalojmë periudha shumë të vështira, kemi qenë gjithmonë të mbikëqyrur nga regjimi i Serbisë. Si student jam kyçur në pajtimin e gjaqeve dhe kam dhanë një kontribut të çmuar, po ashtu edhe në Unionin e Studenteve, sidomos në sistemin paralel jam ndër të parët që i jam përvësuar punës dhe kemi arritur të formojmë Fakultetin e mjekësisë në sistemin paralel.

Ishte një nismë e mirë, e pak-kush ka menduar që ne do të ja dalim, por me mbështetjen e presidentit të ndjerë Rugovës dhe në konsultim të vazhdueshëm me të, ia kemi dalë dhe kemi krijuar sistemin paralel të Universitetit të Kosovës. Pishtarë të parë të këtij sistemi paralel në regjimin e Millosheviqit ka qenë Fakulteti i Mjekësisë. Provimet e para për pranimin e studentëve i kemi organizuar Unioni i studentëve bashkë me shume figura tjera që sot kanë përgjegjësi në nivele të ndryshme të qeverisjes, si qendrore ashtu edhe lokale, si Dr. Afrim Sylejmani, Dr. Kristë Deda, Dr. Fadil Kryeziu e shumë të tjerë.

Drita: Ku ju gjeti lufta, dhe kyçja e juaj në ato rrjedha?

Pal Lekë: Për sa i përket periudhës së luftës, kemi qëndruar në Gjakovë, në Novosellë. Unë edhe përpara kam qenë në kontakt me grupe të caktuara. Kur dikush ka menduar që gjitha ato lëvizje të UÇK po i shkakton regjimi i Millosheviqit, por kanë qenë djemtë tanë që nuk kanë

mundur t'i rezistojnë presionit apo dhunës së Serbisë, dhe janë organizuar në grupe dhe shpesh herë kanë atakuar atë regjim. Unë kam qenë në djeni me disa shokë, e sidomos në profesionin e mjekut, çdo herë kam ditë lëvizjet e tyre dhe kam qenë afër tyre, sidomos në plagët e para.

Të plagosurit i kam shëruar edhe në shtëpinë time në Novo Sellë. Kemi vepruar bashkë me shokë, siç i përmenda më herët. Ishim një gjeneratë, them, ka dashtë fati që ne të jemi më vigjilentë dhe të jemi në nivel të detyrës. Dhe po thuaj se në atë ilegalen tonë, ta quaj ashtu, kemi vepruar dhe më vjen shumë mirë që asnjëri prej shokëve tonë nuk ka qenë i burgosur. Kemi qenë të përpiktë e striktë në veprimet tona dhe e kemi ruajtur sekretin. Në mars kur ka filluar lufta në Glogjan, kur doli në sipërfaqe UÇK-ja, ne kemi qenë të parët që kemi pranuar grupin e parë të nxënësve dhe kemi dhënë shërbimet shëndetësore. Vazhdimisht kemi qenë në përkujdesje të ushtarëve nëpër zona të luftës. Ishte e vështirë, por me një vullnet të mirë kemi kryer një shërbim ndaj atdheut dhe ndaj qytetarëve tanë. Tani më vjen mirë që kemi ditë më të mira.

Drita: Keni kontribuar edhe në ato pikat që keni pasur në shoqatën Nënë Tereza.

Pal Lekë: Ky rrjet i ambulancave ka qenë i shtrirë në tërë Kosovën, por ne, me kolegët e mi kemi qenë në shërbim dhe kemi ofruar shërbime falas pacientëve e qytetarëve në komunën e Gjakovës. I falënderoj udhëheqësin e Shoqatës Bamireshë që na ka furnizuar me barëra e me gjithë ato që kanë qenë të domosdoshme atëherë, kur dihet që sistemi shëndetësor nuk ka funksionuar siç duhet, dhe Shoqata Bamireshë Nënë Tereza, me ambulancat çdo kund në Kosovë, kanë qenë alternativa më e mirë për shërimin e pacientëve. Është një periudhë që duhet ta ketë rëndësinë e vet

“Nëse një politikan e ndjen përgjegjësinë që iu ofron qytetarëve, e ndjen përgatitjen e vet dhe e ndjen që mund të jetë në shërbim të qytetarëve, mund t’ia arrijë shumë lehtë.”

në historinë më të re të Kosovës. Se të krijosh një sistem paralel shëndetësor nuk ka qenë fare e lehtë, por duke u nisur nga vullneti i gjithë kolegëve të mi, i gjithë faktorëve relevant, ja kemi dalë. Me të vërtetë kemi kryer një punë të shkëlqyeshme.

Drita: Kontaktet e juaja me UÇK-në dhe me komandantin e zonës Ramush Hara-dinaj?

Pal Lekë: Kontaktet e mia të para kanë qenë në ditët e para të luftës kur jam caktuar koordinator shëndetësor në rajonin e Dukagjinit, dhe kemi qenë të parët që kemi organizuar një front shëndetësor. Kanë qenë mjetet e para që kanë shkruar nga Gjakova në spitalin ushtarak, në vijën e Deçanit në Krusheq. Ishim të parët që i kemi furnizuar me sallën operative, me gjithë aparaturën që është dashur aty. Kjo ka ndikuar edhe në moralin e ushtarëve e sidomos të popullatës. Kemi organizuar një spital në periudhën e luftës në mesin e bombardimeve nga ushtria serbe. Jemi fokusuar që të kemi një spital të tillë dhe ia kemi arritur ta bëjmë një gjë të tillë. Unë e falënderoj komandantin e UÇK-së, në Rrafshit e Dukagjinit, zotëri Ramush Hajradinaj, i cili ka ditë dhe ka qenë vizionar që edhe në atë periudhë, shërbimet që kanë qenë të domosdoshme për ushtarët, të mendoj dhe ti krijoj të gjitha shërbimet që ishin të nevojshme. Duke filluar nga furnizimi me ushqim, sistemi shëndetësor, kirurgët, mjekët e përgjithshëm. Internistët nga të gjitha profilat kanë qenë aty. E kishim kujdesin e drejtpërdrejtë nga komandanti i zonës.

Drita: Pas luftës jeni kyçur në politikë. Çka ju qoj juve në politikë?

Pal Lekë: Po është vështirë për një mjek që ta lë profesionin, ta lë atë që tërë jetën ia ka kushtuar dhe ka investuar, që të jetë në shërbim të pacientit, në shërim të tyre. Por ajo që më ka shty më së tepërmi është, se si mjek jam munduar që një pjesë të qytetarëve, një pjesë të pacientëve t’iu ndihmoj, por kam menduar se nëse jam në shërbim të mirës së qytetarëve, si politikan mund t’iu ndihmosh edhe më tepër. Prandaj arsyeja kryesore imja ka qenë që të kyçem në politikë për të mirën e qytetarëve, dhe për të zgjeruar gamën e mbështetjeve të qytetarëve, tani jam në politikë.

Drita: Keni pasur vështirësi natyrisht në zgjedhjet e para dy viteve, kur keni pasur kundër-kandidat Astrit Haraqinë, e në veçanti tani para një muaji kur kundër-kandidate ishte Mimoza Kusari-Lila. Çka ju ka karakterizuar juve, që popullata të vendos të zgjedhë Pal Lekën?

Pal Lekë: Për sa i përket përgjegjësi që i kam pasur para kandidimit tim për kryetar komune, mbasi kam qenë i suksesshëm dhe menaxher i mirë në sistemin shëndetësor, kam menduar, nëse kam mundur ta kryej një punë të tillë në shëndetësi, kam menduar se shumë më lehtë e kam të kandidoj për kryetar të komunës. Ato vështirësi dhe sfida që unë i kam takuar në politikë, është diçka tjetër, se ke të bëjë me të gjitha segmentet dhe ka të bëjë me shumë shtresa të qytetarëve. Por më e rëndësish-

mja është që nëse një politikan e ndjen përgjegjësinë që iu ofron qytetarëve, e ndjen përgatitjen e vet, dhe e ndjen që mund të jetë në shërbim të qytetarëve, mund t’ia arrijë shumë lehtë. Tek unë ka mbizotëruar vullneti që mund të bëj dhe që Gjakova mund të ndryshojë. Me një politikë çfarë e kërkon qytetari, me një politikë të ndershme, me një qeveri efektive dhe në shërbim të qytetarëve, me një vizion të qartë se ku do për ta dërguar mesazhin tënd dhe politikën tënde, që çdo herë parasysh ta kesh qytetarin. E gjithë kjo ka qenë tek unë. Dhe mu për këtë unë kam hy në politikë dhe kam sfiduar një figurë, se dihet, Gjakova ka qenë shembull i mirë, shembull i kulturës, civilizimit dhe shembull i mirë i politikanëve në periudha të caktuara që kanë patë përgjegjësinë e qeverisjes së Kosovës, edhe të ish-Jugosllavisë.

Drita: Ju jeni zgjedhur me vota të pastra kryetar i Gjakovës. Këtë e kanë dëshmuar të gjitha strukturat, të gjitha komisionet, dhe është një fitore e pastër si loti. Pse qytetarët e Gjakovës, flas për qytetarët e qytetit të Gjakovës nuk e kanë pranuar aq mirë fitoren e Pal Lekës, ose e kanë pranuar shumë rëndë këtë fitore?

Pal Lekë: Për sa i përket proceseve demokratike, mendoj se i tërë procesi zgjedhor ka kaluar në frymën e një tolerance, një besimi të qytetarëve për njeriun e caktuar dhe mendoj që ka qenë procesi më demokratik që është zhvilluar në komunat e Kosovës. Ajo që u ka bërë përshtypje është që oponentët e mi



“Suksesi im është vullneti për punë, vullneti për të mirë, vullneti për të ndryshuar pozitivisht dhe ndershmëria ndaj qytetarëve.”

kanë qenë të orkestruar, sidomos zonja Mimoza Kusari-Lila, që ka ardhur me një ambicie shumë të madhe, e kur e ka parë që ka përjetuar një humbje nga vota e lirë e qytetarëve, me atë ambicie që ka ardhur se do të jetë fitimtare, është zhgënjyer aq shumë, saqë është mundur t'i zhveshë të gjitha institucionet tona dhe është mundur, dhe kanë qenë të orkestruar në të gjitha këto që i ka atakuar. Unë i garantoj qytetarët që kemi qenë në nivel të asaj që është kërkuar, edhe si kryetar komune. Mirëpo i falënderoj të gjithë qytetarët që më kanë votuar, dhe që dihet në proceset demokratike, vota është ajo që e përcakton kryetarin e komunës. Ashtu është edhe sistemi zgjedhor, por më vjen shumë keq edhe pse dy vitet kanë qenë shumë të suksesshme dhe kam qenë kryetari më i dalluar në Republikën e Kosovës prej kryetarëve të komunave, disa qytetarë nuk e kanë pritë ashtu siç duhet, sepse kanë qenë të manipuluar, nga oponentja ime zonja Mimoza Kusari-Lila, dhe ju e shihni se

edhe në ditët e sotme nuk e ka pranuar procesin më demokratik që është zhvilluar në Gjakovë.

Drita: Votat kanë treguar qartas fitoren tuaj të pastër. Pse qytetarët e Gjakovës nuk kanë dëshirë një kryetar, i cili vjen nga fshati, ku asht problemi këtu? Më duket se në asnjë qytet tjetër të Kosovës nuk ekziston ky problem.

Pal Leka: Ajo që duhet të theksohet, është e vërtetë që ekziston një ndarje, një mendim që çfarë nuk duhet të ekziston në shekullin XXI. Çdo njeri duhet të vlerësohet çka punon, duhet të vlerësohet profesionalizmi, ndershmëria, dhe sa ka bërë për atë qytet e për ata qytetarë. Nuk duhet asnjëherë të vlerësohet nga vjen, kush është, si e ka emrin, mbiemrin, por unë mendoj që këto në mënyrë graduale, qytetarët do të binden që ka kaluar koha kur mund të qeveriset një vend vetëm nga njerëzit që vijnë nga qyteti. Ne kemi një zonë elektorale, kemi ligjin mbi

zgjedhjet komunale, prandaj është shumë vështirë të përcaktohen me diktatë se kush mund të udhëheqë një komunë, por unë i falënderoj të gjithë qytetarët që më kanë votuar, e sidomos ata që kanë mendim të ndryshëm, por i ftoj që t'i bashkëngjiten karvanit, t'i bashkëngjiten të mirës, t'i bashkëngjiten procesit që e kërkon koha. Dhe unë i garantoj të gjithë qytetarët se do të jem kryetar i gjithë qytetarëve, pa dallime krahinore, pa dallime se nga cili region vjen, çfarë feje ka, por jam kryetar i gjithë qytetarëve dhe kështu do të silllem edhe për ata që kanë menduar ndryshe.

Drita: Unë në shaka e kam thënë se më lehtë e ka pasur Barak Obama të fitojë në Amerikë se sa Pal Leka në Gjakovë. A keni vështirësi të punoni me njerëz të qytetit, ju si kryetar që vini nga zona rurale?

Pal Leka: Jo, nuk e kam pasur të vështirë dy vitet e mëparshme, shpresoj që edhe

në këto katër vite nuk do ta kem vështirë, sepse qytetarët kanë filluar të binden se ka ndodh një proces demokratik, dhe në demokraci ai që merr më shumë vota, e merr edhe pozitën. Prandaj në këtë drejtim unë nuk shoh ndonjë pengesë. Por ka edhe grupe të caktuara që i pengon. Ndoshta i pengon ajo që nuk e kanë përjetuar të mirën për shumë vite, por procesi politik është ky, dhe mendoj që nuk do të hasi në vështirësi të caktuara.

Drita: Njiheni si kryetari më i suksesshëm i komunave të Kosovës, në mandatin e kaluar. Ku fshihet çelësi i suksesit të Pal Lekës, në punën si një kryetar komune?

Pal Leka: Suksesi im është vullneti për punë, vullneti për të mirë, vullneti për të ndryshuar pozitivisht dhe ndershmëria ndaj qytetarëve. Edhe profesioni im si mjek ndoshta më mundëson që të jam shumë më afër qytetarëve, dhe mendoj se mbi të gjitha është përgatitja për një menaxhim çfarë kam punuar, është përvoja ime. Për këto katër vite, koha është shumë më e gjatë se sa mandatin e kaluar. Mendoj se qytetarët e Gjakovës do të përfitojnë shumë këto katër vite. Prioritet i imi do të jetë punësimi, zhvillimi ekonomik, lokal, dhe pas katër viteve Gjakova do të duket shumë më ndryshe. Do të bëhet privatizimi i të gjitha ndërmarrjeve, dhe të mos flasim për infrastrukturë që në çdo cep të Komunës së Gjakovës, si në zonat rurale apo urbane do të kryhen brenda këtij viti, dhe mendoj që Gjakova është në rrugë të mbarë. Do të jetë një shembull i mirë i qeverisjes së parashë publike, i respektimit të ligjit dhe në fokus timin është që unë të mos jam mbret, por mbret do të jetë qytetari.

Drita: Ju njiheni si kryetar që nuk e ka asnjë njollë për sa i përket korrupsionit. Këtë e kanë dëshmuar edhe të tjerët, por a ka korrupsion në institucionin që ju e drejtoni, këtu në kuvendin komunal, dhe në institucionet tjera që janë në komunën që ju e drejtoni?

Pal Leka: Më gëzon fakti që për dy vite nuk ka pasur asnjë afër korrupsionit, më gëzon fakti që qytetarët në mandatin tim e kanë krijuar një besueshmëri ndaj institucioneve lokale, por asnjëherë nuk mund të themi që nuk ka keqpërdorime, mund të ketë keqpërdorime të vogla, por po e them se Gjakova është shembull që korrupsioni për dy vite nuk është përdor për një zyrtar, por kjo nuk do të thotë se e kemi kryer punën tonë. Fazat e tranzicionit gjithmonë janë të rrezikshme. Ju e shini çdo ditë flitet për këtë problem. Por korrupsioni nuk luftohet me fushatë, luftohet duke respektuar ligjin, duke krijuar mekanizmin e kontrollit të institucioneve,

dhe duke përzgjedhur njerëzit më adekuat në institucione që kanë ndjenjë institucionale dhe ndjenjë ndaj qytetarëve. Ju e shini sa shumë politikanë tanë nga qendra, brenda vitit, ndoshta përpara nuk kanë pasur asnjë makinë, e tash kanë edhe ndërtesa e makina luksoze. asgjë nuk ju mungon. Korrupsioni është kancer për një shoqëri. Nëse këtë dukuri, këtë kancer e zhdukim, Kosova do të ketë prosperitet. Por nëse ndodhë e kundërta ne do të mbesim këtu ke jemi, dhe larg do të jemi synimeve tona, për Bashkimin Evropian.

Drita: Kur keni dalë të Bashkimi Evropian dhe lëvizjet globale, ku e sheh Pal Leka vetën pas katër viteve?

Pal Leka: Dëshira ime është që të jam në një periudhë të gjatë në politikë që mund të bëj më shumë për qytetarët. Unë asnjëherë nuk i synoj majet, por i synoj lartësitë. Nuk i fshih, dhe mendoj që pas katër viteve do të ndryshoj pozitën, por varet prej qytetarëve, nëse qytetarët e kërkojnë vendin se ku do të jam, unë do të shkoj me fuqizimin e qytetarëve.

Drita: Ku e ka Kosova vendin e vet?

Pal Leka: Kosova nuk ka rrugë tjetër përpos Bashkimit Evropian, vlerave perëndimore dhe të gjithë politikanët jemi të vetëdijshëm për këtë punë, dhe po punojmë, fare nuk e vë në dyshim, sepse jemi pjesë e Evropës, kemi qenë dhe do të bëhemi pjesë e Evropës.

Drita: Kthehemi edhe një herë në Gjakovë. Gjakova e ka një figurë shumë të madhe, është Gjon Nikollë Kazazi, i lindur, i rritur dhe i varrosën në Gjakovë. Varri i tij është në Çabrat, i dihet parcela por nuk dihet vendi, çka do të bëjë një kryetar i komunës sikur ju, për përkujdesjen e një figure kaq të madhe?

Pal Leka: Një kryetar komune duhet t'i vlerësojë vlerat, pa marrë parasysh periudhën kur ka ndodhur, dhe mendoj që është obligim i yni, që në çdo vlerë që ka zënë vend në histori të kujdesemi. Sepse duke i ruajtur ato vlera, ruajmë trashëgiminë tonë. Gjon Nikollë Kazazi, një personalitet çfarë duhet të mburret jo vetëm Gjakova, por edhe i mbarë kombi, prandaj unë ju garantoj që do të përkujdesëm vet dhe do të shikoj që ai ta zë një vend të merituar në këtë periudhë, në këtë historinë më të re të Kosovës. Mendoj që figura e Kazazit e meriton, sepse ka qenë ndër figurat më të shquara të Gjakovës e të popullit shqiptar.

(Intervistoi:
Patën Nue Kajaziti)

Famullia e Binçës

- oazë e thirrjeve të shenjta

■ PËRGATITI:
Marjan Sebah - SOPI

Topografia dhe etimologjia

Binça është një fshat i bukur piktoresk, i rrethuar me bjeshkët e larta të Maleve të Zeza *Montenegro* (zonë kufitare Kosovë-Maqedoni). Fshati ndodhet në pjerësitë jugperëndimore të maleve të Karadikut dhe është një ndër fshatrat më të lashtë të Ana Moravës. Binça përshkohet nga lumi i madh apo Morava e Binçës, e cila ka burimin diku rreth 12 km larg nga fshati. Këtë bukuri të rrallë e pasuri të madhe natyrore rrafshinoro-malore e zbukurojnë lumi Morava dhe lumi tjetër që e quan populli *lumi i vogël* apo *jazi* që kalon në anën tjetër të Binçës, nëpër pjesën e quajtur Razor. Gjithë ky peisazh jep bukurinë e saj mëgjepse me prapavijën e kodrave dhe maleve, fushën pjellore, shtëpitë e bukura, rrugët e ndriçuara dhe të bukura që lidhin Binçën me pjesët e saj, pastaj lagjen Shushkët (me një grykë të mrekullueshme fushore përmes cilës kalon lumi Moravë) dhe fshatin Kabash e që të gjithat lidhen me qytetin komunal, pra Vitinë që është larg Binçës 1.5 km.

Binça, si fshat ka një histori të lashtë lliro-romake, por edhe jo mjaftë të gjurmuar dhe zbardhur. Popullata është shqiptare dhe katolike dhe disa familje serbe, ortodokse.

Rreth emërimit të fshatit ka disa interpretime dhe zberthime historike dhe etimologjike. Disa thonë se fjala Binçë rrjedh nga fjala BIS apo Binekses (Bineç) sipas dy lumenjve që bashkohen pikërisht në fshat e që e karakterizojnë këtë vendbanim. Kurse disa tjerë pohojnë se emërimi rrjedhë prej qytetit të lashtë romako-ilir ARRIBANTUM e cila lokalizohet nga historiani e arkeolog në anën e Binçës së sotme, saktësisht lartë në rrafshin e kodrinës mbi rrënojat e kalasë së vjetër të fshatit. Këtë vështrim dhe interpretim që duket të jetë mjaftë i saktë dhe i besueshëm e vërteton edhe kjo kalajë e lashtë, e cila gjindet në afërsi dhe ngjitur me fshat, në të cilën gjinden shumë gropa, zgafella, koridore nëntokësore për nxjerrjen e xecheve dhe mineraleve. Mbi rrafshinën e kalasë ku deri vonë ruhehin dhe shiheshin themele të shtëpive, ndërtimeve dhe kullave tjera, sot ende gjindet si gjurmë edhe

një kishës (kapelë) e vogël, cilën në kohërat e reja e meremetuan dhe uzurpuan së bashku me tokë e pyll serbët lokalë dhe e cila sot është pronë e Kishës ortodokse. Mirëpo, që nga kohërat më të lashta dhe tradicionalisht besimtarët e fshatit, dmth katolikët shqiptarë, deri vonë shtegtonin për festën e Shën Prenës, të cilës edhe i është e kushtuar kjo kapelë (flitet se në këtë hapësirë ka pasur kishë qysh nga shekulli i pestë).

Binça përmendet edhe në relacionin e Imzot Pjetër Mazrekut mbi *Martirët e Karadikut* ku përmend edhe Binçën si filialë e Letnicës. Por, gjatë këtyre 70 viteve famullia ka përjetuar një lulëzim dhe përparim të jashtëzakonshëm në çdo kupim dhe drejtim. Binça si famulli përfshin edhe Kabashin dhe Vitinë. Në Kabash jetojnë në harmoni shqiptarët katolikë dhe ata myslimanë. Dikur kishte edhe disa familje serbe, të cilat pas luftës së vitit 1999 janë shpërngulur gjeti.

Kisha dhe famullia

Binçën si famulli e ka themeluar ipeshkvi dr. Smiljan Franjo Çekada (1940-1967), ipeshkvi i atëhershëm i Shkupit në vitin 1946, pikërisht në 100 vjetorin e *Martirëve të Karadikut* (1846-1848), d.m.th të Stullbës, Binçës, Vërnakollës dhe Terziajve.

Kisha, kushtuar shën Antonit të Padovës, fillojë të ndërtohet në vitin 1968 (më parë ekzistonte një kishë - shtëpi ku u thonte mesha dhe kryheshin ceremonitë tjera fetare) dhe hapur për Krishtlindjen e vitit 1972. E veçanta e kishës në Binçë, janë pikturat e bëra në vitin 1989 - 1991 Piktura gjigante është ideuar dhe realizuar nga piktori preshevar Demir Behluli dhe ndihmësi i tij Zeqira Rexhepi. Të gjitha pikturat murale zënë një sipërfaqe prej 650 metër katror, ku janë pikturuar 520 figura të ndryshme, shumica e të cilave janë portrete të personazheve historike të historisë së kombit tonë, gjegjësisht golgota e Martirëve të Karadikut (1846 - 1848) dhe motivet tjera nga Bibla, nga Besëlidhëja e Vjetër që nga krijimi i botës deri tek Elia profet, e nga Besëlidhëja e Re nga Lajmërimi i Marisë deri tek ringjallja. Dhe këto piktura tërheqin vizitorë të shumtë edhe sot e kësaj dite.

Famullitar i parë i Binçës ishte don Dedë Ramaj (1946-1960) më pas famullitar ishin:

Don Luka CIRIMOTIĆ

(1960-1967), Don Vjekoslav IVANOVIĆ (1967-1970),

Don Nikola DUČKIĆ (1970-1974), Don Pjetër BERTI-SHA (1974-1975), Don Ndue GJERGJI (1975-1993), Don Lush Gjergji (1993 - 2007), dhe tani Don Albert Demaj.

Assesi nuk duhet harruar këtu edhe kontributin e madh të ndihmës famullitarve, siç ishin Pater Ambroz Ukaj, atëherë ishte meshtar diqezanë, don Tomë Pjetri, don Mikel Sopi, e në veçanti kontributin e madh të don Marjan Demaj dhe teologut z. Marjan Sebah-Sopi në pastoral dhe aktivitetet kulturore, sportive etj. Në famulli shërbejnë motrat e Kongregatës *Bijat e Dashurisë Hyjnore* që nga viti 1961. Sot shërbejnë 6 motra, dhe don Kolë Zefi, i cili gjatë vikendeve dhe festave shkon në Peshter, ku është famullitar.

Përpos kishës famullitare, kemi edhe dy filjala: Në qytetin e Vitisë është kisha Zëmërës Krishtit. Objekti ka formë Anije dhe qendren pastorale, ndërtuar pas luftës në Kosovë. Mesha këtu është çdo të premte me pjesëmarrje të madhe të besimtarëve të ardhur edhe nga famullitë fqinje, dhe katekizimi për fëmijët e Vitisë Në Kabash, është kisha kushtuar shën Nikollës, e punuar viteve të '80, ku mesha celebrohet të dielave e të enjteve, dhe festave, si dhe shtëpia famullitare e cila shfrytëzohet për mësim feje etj.

a) Jeta shoqërore

Infrastruktura në fshatin Binçë dhe në një pjesë të Kabashit, është në nivel, ndriçimi dhe rruga e asfaltuar, kanalizimi, telefonia fikse, interneti, ujësjellësi. Në Binçë është shkolla katërklasëshe. Në Kabash është shkolla tetëklasëshe. Kurse, ata që dëshirojnë t'i ndjekin mësimet e shkollës së mesme shkojnë në Viti.

Famullia është mjaft e organizuar në aspektin shpirtëror dhe organizativ. Përveç meshëve të përditshme, me pjesëmarrje të madhe të besimtarëve, kemi përshpirtërinë e të premteve të para, me vizitë të të sëmurve dhe pleqve nëpër shtëpitë e tyre, ad-

hurim 30 m para Shejtnushmit Sakrament çdo të enjte në mbrëmje, ku marrin pjesë më tepër se 100 besimtarë. Kemi Shoqatën e të Rinjve *Imzot Mark Sopi*, që organizon aktivitetet të shumta ligjërata për të rinj, shëtitje, turnire, ahengje etj. Po ashtu kemi edhe Shoqatën e fëmijëve *shën Dominik Savio*, që organizon aktivitetet për fëmijë. Kemi fletushkën e famullisë *shën Antoni i Padovës* dhe vebseitin e famullisë. Pastaj Karitasi i famullisë që mirret me ndihmat ndaj të varfërve, të cilat i mbledhim nga besimtarët tanë. Sivjet kemi ndërtuar një shtëpi dhe kemi meremetuar të tjera për besimtarët tanë me vetkontribut.

Në kuadër të famullisë ekziston edhe ambulanca ku punojnë motrat tona, të cilat shërbimet dhe ndarjen e barnave e bëjnë falas. Brenda ditës ato vizitojnë mbi 20 pacientë në ambulante e shumë të tjerë në shtëpitë e tyre. Motrat në ambulancën tonë e dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm sidomos gjatë helmi-meve në vitet e '90. që ndodhën në Kosovë.

Thirrjet meshtarake dhe rregulltare

Kjo bashkësi famullitare ka dhënë shumë thirrje meshtarake dhe rregulltare. Meshtar i parë nga ky fshat ishte biri i kësaj famullie don Mark Sopi (1838-1888), që si fëmijë kishte depërtuar bashkë me martirët tjerë (1846 - 1848), e që fatmirësisht u kthye i gjallë me pak besimtarë të tjerë, si dhe disa motra nderi nga familja e ngusht Gegaj e që shërbyen në Francë (fati i të

cilave është shumë pak i zbardhur).

Rrugën e dashurisë dhe flimit për të mirë të vëllait dhe motrës njeri e ndjekën edhe tashmë i ndjeri ipeshkvi Imzot Mark Sopi (1938-2006), don Damjan Kurti (Durrës), don Franë Sopi (Pejë), don Viktor Sopi (Ferizaj dhe drejtor i Karitasit të Kosovës), don Lenc Sopi (Klinë), don Lush Sopi (Novosellë), don Mikel Sopi (Zvicër) don Marjan Marku (Velezhë), don Frrok Zefi (Kroaci), don Tomë Pjetri (Mali Zi), don Izidor Llukuqi (Selezian, Prishtinë), don Herbert Berisha (Stubël). Po ashtu nga kjo famulli kanë fituar thirrjen shenjta edhe më se 25 murgësja, prej të cilave 10 janë *Bijat e Dashurisë Hyjnore*, 3 françeskanë, 3 të Shën Filip Nerit, 2 të Shën Vinçencit dhe 2 baziliane, cilat shërbejnë në të gjitha viset shqiptare dhe në shumë shtete tjera evropiane dhe Amerikë.

Në famullinë tonë festohen këto festa: Në Binçë: Shën Masjani me 20 janar, Shna Ndou 13.VI. (festa e famullisë), shën Elia (20 korrik); në Kabash shën Kolli (6 dhjetor) dhe festa e Zemërës Krishtit në Viti.

Dhe për fund disa statistika të vitit të kaluar: 27 pagëzime, 20 fëmijë e kanë marrë kungimin e parë, 24 krezmimin, 16 kurëorëzime, 9 varrime. Janë paguar 980 meshë dhe janë ndarë 36000 kungime. Në famulli jetojnë 1065 besimtarë, jashtë 1200 më së shumti në Zvicër dhe Itali.



Rugova i përjetshëm

■ SHKRUAN:
Ndue UKAJ

Misionari nuk vdes. Ai, si orakull, predikon për misionin, bashkon grigjën rreth idesë së shenjtë të misionit dhe shkon në Përtjetësi, duke lënë pas vete shpirtin, frymën e misionit, që enden si shkëndija udhërrëfyes për breza të tëra. Presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, iku, në një janar të akullt, në një janar që i ngrinte lotët e shumë që vërshonin rrugëve të Prishtinës dhe kudo kishte shqiptar.

Ai iku, mirëpo la pas shumë, mbase më shumë se çdo politikan, sepse ai më së paku ishte politikan. Ai ishte një humanist i pashembullt, i prirur nga idetë me sublime të etikës dhe politikës, të cilat i sintetizoi drejt një ideali sublim, që kapërcente kufijtë e pavarësisë dhe rikthente shqiptarët në shtratin e tyre natyral perëndimor, pa ekoivoke e interpretime deshakëqija. Rugova ishte një artist i mirëfilltë, i cili njohu eksperiencat më të sofistikuar të artit botëror e shqiptar. Rugova ishte një moralist i madh, sa për shumëka tejkalohe edhe vetë predikatoret e ndryshëm religjioz. Ai ishte një filozof, i cili flajën e latonte aq mirë, sa brenda saj shtrësosheheshin shumë domethënie, që bota për rreth tij vështirë i kuptonte. Rugova ishte një studiues i jashtëzakonshëm, i traditës dhe i modernës, i pakompromis me dukuritë degraduese në art e letërsi- një studiues që letërsisë sonë i mungon edhe sot. Dhe pra, Ai ishte një politikan karizmatik, që këtij domeni kaq shumë të urreyer ndër shqiptar, i dha dimension tjetër, duke e përmbush me shpirtin e fisëm të thellësive filozofike e letrare, etike e nacionale. Kështu, u bë përjetësisht një lkonë Kombëtare.

Presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugov iku, e mori një janar i akullt, një janar i trishtë, mirëpo shpirti i tij jeton e do të jetojë përjetësisht. Ndërkaq, ata lotët e ngrirë para katër vite, ende pikojnë nga sytë e mërziut të shqiptarëve, që e deshtën dhe e duan aq shumë. Dhe sot, në janarin e akullt, të përvjetorit të katërt të ikjes së tij fizike nga kjo botë, shpirti i tij, mençuria dhe virtytet e tij, rezatojnë triumfalisht mbi botën vobektë politike shqiptare, tamam si Ylli i përjetësisë Biblike, ai ylli i Davidit, të cilin e mishëroi në flamurin e tij shumë domethënës, si shenjë e shënjesë të shtetësisë dhe ardhmërisë së Kosovës dhe shqiptarëve. E, të cilin flamur e përbuzën ca injorantë.

Ibrahim Rugova, emri i përveçëm i politikës dhe kulturës shqiptare, kishte tiparet e misionarëve të mëdhenj të njerëzimit, të atyre që lënë gjurmë e përjetësojnë kohët.

Puna dhe veprimtaria e Rugovës, i ngjason aq shumë profetit Biblik, Mojsiut. Sikur Ai, edhe Rugova e nxori popullin e tij nga kthetrat sllave, por nuk e përjetoi pavarësinë, atë tokë të premtuar, për të cilën bëri shumë, aq shumë sa do të duhen kohë për ta njohur thelbësisht. Kjo për faktin, sepse ai ishte i frymëzuar nga parime profetike. Kishte diçka profetike në qenien e tij, në flajët e tij, që tingëllonin si kambana alarmuese për një botë të tërë, që bënte heshtje karshi çështjes së Kosovës dhe shqiptarëve. Flajët e tij, si gurë të çmuar e xhevahire të shtrenjta, tingëllonin si njato kambanat e panjohura, që përhapin lajme të kobshme. Dhe kështu, përçoi çdo kund ku duhej, mesazhin e fuqishëm, të pakundërshtueshëm, as nga fuqitë më të mëdha të tokës, se po shkelej mbi Dardaninë antike, po diskriminohej e vritej popull i Shën Florit dhe Laurit, i Gjergj Kastriotit dhe Pjetër Bogdanit, i Nënë Terezës dhe i shumë e shumë figurave që kishin lënë gjurmë në qytetërimin perëndimor, prej së cilit, shqiptarët ishin përjashtuar padrejtësisht.

Rugova kishte dy misione jetësore, të liri popullin e tij nga kthetrat e Serbisë dhe ta rikthej atje ku duhej, në shtratin perëndimor, me gjitha tiparet autentike shqiptare, duke tund, njëherësh, gjitha shtrësimet që i ishin mveshën padrejtësisht. Për këtë, ai krijoi, si askush, marrëdhënie me aleatët e të madhit Gjergj Kastriotit - filozofi kjo të cilën ai e ndjeku në çdo hap të jetës së tij.

Kosova, shqiptarët dhe bota e moderuar, para katër vite nuk e humbën vetëm një lider të thjeshtë. Sepse kjo ishte humbje e prijesit, misionar dhe ideatori i gjitha ndryshimeve të mëdha që ndodhën në Kosovë dhe më gjerë. Kjo ishte humbje e njeriut që ndikoi në ndryshimin e relacioneve politike në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Filozofia e tij politike, ishte diçka magjike, sidomos për botën perëndimore, e cila dridhmohej nga magjia e filozofisë paqësore, që dilte nga një rajon i stërm-bushur me urrejtje, luftëra, krime.

Me dhuntitë e pashembullta, ai doli kundrejt një politike vrasëse, që prodhonte vetëm shkatërrime dhe dhunë, duke ndërtuar një shtet paralel brenda një regjimi të çmendur. Dhe kështu, ngazëlëu zemrat e botës, e të sa e sa prijesve politikë, të kombeve të mëdha, që i dolën zot

kombit të tij, ashtu sikurse deshi ai. Është kjo magjia e fuqisë së paqes, e fuqisë së besimit, e fuqisë së drejtësisë, një magji e tipit Promethean, të cilën diti ta jetësoi një njeri si Ai. Po ashtu, kjo fuqi dëshmoi se sa të pafuqishme janë pengesat ndërkombëtare, kur ishte në pyetje domosdoja e mbrojtjes së Kosovës. Bota e tëra u rreshtua pas misionit të tij të përcaktuar jetësor.

Kalimi i tij i shpejt nga kjo jetë, për t'u bashkuar me të dashurit e tij, që aq shumë i mbante në gojë, si Gjergj Kastriotin, Pjetër Bogdanin, Gjon Palin e Dytë, Nënë Terezën, ishte një shenjë e përjetësimi të profetit e heroit, që kryen punën dhe ikën.

Po a nuk është ky fat i gjithë heronjve të mëdhenj?

Si prodhim i filozofisë, urtësisë dhe strategjisë së tij, Kosova sot është shtet i pavarur, ndërkaq sendërtimi i idealeve të tij, është bërë, por pa të. Mirëpo, është një dëshmi e fortë se puna dhe vepra e tij po përjetësohen, kudo ka shqiptar, Ai nderohet me pietetin më të lartë, jo vetëm si nderohen politikanët. Ai është përjetësuar në art e kulturë, duke u bërë, tamam hero i Kosovës së djeshme, i Kosovës së sotme dhe i Kosovës hero i Kosovës së dëshirave të nesërme.

Dr. Ibrahim Rugova ishte dhe do të mbetet ideator i një politikë moderne, jo vetëm shqiptare, por universale. Mjafton të rikujtojmë në strategjinë e tij brilante, Kosova e Pavarur, Integrim në Strukturat Euroatlantike dhe Miqësi permanente me SHBA-të. Me urtësinë e tij, Ai në çdo takim me rëndësi, në çdo flajm, flajët e ruante si visare të çmueshme dhe përshëndeste miqtë e liderët botëror, që nga SHBA-të deri të Vatikanit. Një vizion, që edhe nëpër shekuj duhet të ndiqet.

Presidenti Ibrahim Rugova nuk ishte, dhe nuk do të mbetet në kujtesën tonë kombëtare e botërore, vetëm si lider i përmasave të thjeshta politike, të tillë që bota ka shumë. Në panteonin e vlerave të mëdha, figura e tij mbetet, mbi të gjitha, me dimensionet e një mendimtar të madh, që politikë si dha dije, ide, filozofi e kulturë. Ai e krijoi një model kulturor të jashtëzakonshëm, admirues për gjithë botën e përparuar. Së këndejmi, Ai do të mbahet mend si një iluminist që mishëroi dimensionet etike me ato politike, një personalitet me shpirt të gjerë dhe human, një dijetar i madhe i shkencave shoqërore dhe një kritikë letrar me dije enciklopedike, një shpirt rilindësi - dhunti këto të cilat diti mrekullisht t'i funksionalizoi, në të mirë të idesë së demokracisë, lirisë, pavarësisë dhe integriteteve.



“Puna dhe veprimtaria e Rugovës, i ngjason aq shumë profetit Biblik, Mojsiut. Sikur Ai, edhe Rugova e nxori popullin e tij nga kthetrat sllave, por nuk e përjetoi pavarësinë, atë tokë të premtuar, për të cilën bëri shumë, aq shumë sa do të duhen kohë për ta njohur thelbësisht.”

Në një betejë të rëndë, me sfida të rrezikshme, Ibrahim Rugova niset me besimin e tij, si një forcë shtytëse, me dijen e tij, si një pasuri, që i dha mundësi të argumentoi një kauzë, me përcaktimin e tij të pa alternativë, si virtyt i pashoq që u admirua nga gjithë bota e civilizuar.

Janë këto virtyte dhe vlera kolasale që këtij njeriu i japin përmasa universale.

Në një rrugëtim të gjatë, Ibrahim Rugova u nis tamam si prijes, misionar e profetë. Me urtësinë sokratiane, me dashurinë për atdheun, të frymëzuar nga modeli e ati i tij shpirtëror, Pjetër Bogdani, së cili ja kushtoj një pjesë të punës intelektuale; i frymëzuar nga vlerat e filozofisë johunore të njohura në Botë, Rugova u bë Ikona e Shqiptarëve dhe e botës së përparuar në këto dy dekada.

Duke qenë krenar se i përkiste atdheut të madhit Gjergj Kastriotit - Skënderbeu, të së madhes Nënë Tereza, ai asimiloi dijen, guximin dhe besimin, me zërin e thellë të ndërgjegjes kombëtare

dhe tundi pluhurin shekullor që kishte mbërthyer qenien shqiptare. Ai filloi t'u rikthej dinjitetin shqiptarëve, të rilidh ato aleanca të vjetra, me aleatët e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Këtë mision e realizoi dhe e bëri shkollë nacionale.

Presidenti Rugova ishte, është dhe të mbetet Hero, ashtu siç njihen në histori heronjtë e mëdhenj të cilëve njerëzimi ju beson. Si i tillë, ai është një hero, sepse politikës i dha shpirt artistik, angazhimeve kombëtare ju dha dimensione universale. Kështu që, personaliteti i tij do të jetë i papërsëritshëm, sepse heronjtë janë Një, dhe vetëm si të këllill kanë kuptim. Nuk do të kishte kuptim civilizimi ynë t'i ketë dy Dante Aligera, dy Xhorxh Uashingtona, dy Gjergj Kastrioti, dy Pjetër Bogdana, dy Shekspira, dy Nene Tereza, dy Papa Gjon Pali II, dy Ibrahim Rugova. Këta në histori mbesin të vetëm, pa shembëlltira. Si të këllill, janë unikat dhe shpirta që udhërrëfjën grigjën.

Recension

Metafizika e Dashurisë

Më 13. Janar në sallën e MBKUK së në Prishtinë u mbajt promovimi i librit me tregime „Stuhi e fjetur” e shkrimtarit Vilson Culaj

Libri i parë me tregime dhe i katërti me radhë i autorit Vilson Culaj sjell 49 tregime të ndryshme që si tëmë të përbashkët kanë dashurinë.

Pas dy librave me poezi dhe një romani, autori Vilson Culaj e sprovon vetën edhe në fushën e tregimit. Në promovimin e librit të tij të ri me titull „Stuhi e fjetur”, në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, me kumtesat e tyre u paraqiten studiuesit e letërsisë Prend Buzhala dhe Flamur Maloku.

Duke folur për këtë libër, i cili është botuar nga shtëpia botuese „Anton Pashku”, Prend Buzhala, që është edhe redaktor i librit, theksoi se kryetemat narrative e këtyre tregimeve është dashuria. Culaj, sipas Buzhalës, e ka intuitën për t'i kapur dhe kuptuar kërkesat e rrepta të tregimit, siç është shndërrimi i segmentit jetësor në fiksinonin e pastër tregimtar, apo siç janë figurat reale historike që shndërrohen në karaktere të tregimit. „Sado që të 49 tregimet përshkohen nga e njëjta frymë e thelbit të dashurisë, të dashurisë si emocion në mes mashkullit dhe gruas, dashurisë për vendlindjen, dashurisë si humanizëm universal, megjithatë ndarja e tillë përshihet në sistemin tipologjik tregimtar. Kështu dy ciklet e para mbështeten në poetikën e narracionit të thjeshtë tregimtar, ndërkaj dy ciklet e fundit ngërthejnë një tipologji tjetër që e pasuron krijimtarinë e autorit Vilson Culaj, atë të tregimit parabolik, meditativ e metafizik dhe atë të tregimit poetik e lirik”, u shpreh Buzhala.

Tregimet e këtij libri janë ndarë në katër cikle: 'Vajza hoqi lotin nga qerpiku me majë të gishtit', 'Ajo shpoi gishtin me gjilpërë pranë dritares', 'Metafizika e dashurisë' dhe 'Zëri i dytë'. Buzhala theksoi se te cikli i parë tematika e dashurisë këndvështrohet në shumë anë. „Nga sekrete të shumta, të fshehta ekzistenciale, vibrime shpirtërore misterioze të pas-kajshme, sikur që është tregimi 'Aborti', ku poenta bie te femra si oqean sekretesh, siç shprehet personazhi, apo te bukuria që ankohet me të bukurën e saj, me dhimbjen nga tundimi”, tha Buzhala.

Ndërkaj, referuesi tjetër, Flamur Maloku, u shpreh se tregimet e këtij libri dalin në frymë të veçantë e në diskurs të veçantë. „Secili tregim ruan farën e vetë të shkrimit e meditimit. Ruajtja e



veçantisë është ruajtja e figurës-jetës. Aty ku është shkrimi, formulohet jetëgjatësi i shpirtit e jetës”, u shpreh Maloku. Ai shtoi se si ide dhe si rrëfim, në përgjithësi shënjon katarzën shpirtërore përballë shkrimit e fiksonit në vijën e filozofisë njohëse. „Kur themi filozofi njohëse, nënkupton njëherësh se autori shtjellon tema në kuptimin e njohjes e të rinjohjes, të cilat njohje, rrëfimin e tregimeve e dërgojnë drejt një katarze shpirtërore e universale”, tha ai.

Ngjarjet e dëshmuara në rrëfimin e tregimeve, sipas Malokut, nuk kanë një pikë mbështetëse, dhe nga kjo krijohet rrëfimi, i cili rrëfim nuk ecë në një linjë, por në esencë krijon një besueshmëri para lexuesit, të cilat ngjarje hynë dhe shpjellohen, duke u argumentuar dhe komentuar nga pozicioni rrëfimtari. „Këto ngjarje tani të shënuara dhe të argumentuara, e të përshkruara nga një narrator i gjithëdijshëm, padyshim, si ide në kuptimin e kërkimit, dhe në ndërthurjen e vetëdijes njohëse, lexuesin e bëjnë për vete, më të cilat ngjarje lexuesi mishërohet, madje e bënë edhe të identifikohet me to. Kështu, gnoseologjia dhe estetika e përshkrimit të ngjarjeve, nëpërmjet situatave, narrative, të cilat karakterizohen në pikat themelore, të strukturës tekstore, padyshim shoqërohen me një emocionalitet në kuptimin e përjetimit gjatë rrëfimit të tregimeve”, u shpreh Maloku. Ne fund autori i librit vilson culaj falënderoj miqtë e tij krijues duke i veqar ketu redaktorin e këtij libri Prend Buzhala, recensuesit, Ndue Ukaj dhe Pal Canaj, si dhe krijuesit e njohur Naum Prifti, dhe Anton Gojçajn të cilët në këtë libër përfsihien me nga një koment recensional. Me pas për te pranishmit ne hollin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare te Kosovës u servua një koletej miqësor me krijuesit dhe te ftuarit.

Alfred Beka

Familja – burim jete, edukimi dhe dashurie

■ SHKRUAN:

Don Lush GJERGJI

Jetojmë në një kohë të ndryshimeve të mëdha, ndërrimeve rrënjësore, përshpejtimeve të llojllojshme. Duket se dita-ditës ndërron shumëçka, mos të them gjithçka. Megjithatë njeriu është dhe mbetet gjithnjë njeri, me shumë nevoja, kërkesa, dëshira, gëzime, hidhërimi, suksese, mossuksese, siguri, pasiguri, ëndërrime, urrejtje, dashuri...

A thua vërtet gjithçka duhet ndërruar, pyetemi gati çdo ditë. Pyetja tjetër në mendjen dhe në zemrën e njeriut është kjo: deri kur dhe ku do të vazhdojnë këto ndërrime? Çka do të na sjellin ato neve dhe pasardhëse tanë? A do të jetë më e mundshme të shpëtohet së paku diçka, mbi të gjitha njeriu, familja, shoqëria?

Dhe pyetjet e tilla nuk kanë më të ndalur, janë një "zinxhir" i paskajshëm. Ndryshimet e shpeshta dhe të shpejta më së tepërmi e kanë goditur "çerdhen" e njeriut, njeriun, familjen, e në familje, geniet më të brishta, fëmijët dhe të moshuarit.

Fëmijët tashmë janë të censuar dhe të rrezikuar në shumë mënyra, prej abortit apo dështimit, vrasjes së tyre para lindjes, deri te keqpërdorimi, pedofilia, shkakullit, braktisja, varfëria, mungesa e edukimit, mbi të gjitha mungesa e dashurisë.

Të moshuarit tashmë janë "tepricë", ngarkesë, të anësuar dhe të përjashtuar nga familja dhe shoqëria, pa ndonjë siguri dhe përkujdesje.

Dikur ndër ne shqiptarët urimi më i bukur ishte ky: u plakësh! E sot, sa duket, ky bekim është shndërruar në një lloj mallkimi!

O tempora, o mores! thoshin latinët e vjetër, që domethënë: O kohëra, o tradita!

Ja disa porosi bazë të Nënës Tereze lidhur me familjen, fëmijën dhe dashurinë.

“Ndryshimi i shoqërisë duhet të vijë nga familja, nga shtëpia e secilit... Familja që lutet së bashku, mbetet e bashkuar. Fryti i lutjes është feja /besimi/, fryti i fesë është dashuria, fryti i dashurisë është shërbim – dashuria në veprim...”

Familja ime ishte e lumtur, me shumë kujdes dhe plot me dashuri... Këtë dashuri që ma ka dhuruar mua Zoti nëpërmjet familjes, pastaj nëpërmjet familjes rregullare, unë iu kam dhuruar të gjithëve...”

“Një fëmijë është gjithmonë një dhuratë e Zotit... Çdo jetë është dhuratë e dashurisë së Zotit.

Edhe fëmija i palindur e ka jetën e Zotit. Ne nuk kemi asnjë të drejtë ta shkatërrojmë këtë jetë...”

Më 7 dhjetor 1988 tërmeti në Armeni kishte shkatërruar shumë shtëpi dhe kishte mbytur shumë njerëz, ndër të cilët kishte edhe mjaft fëmijë.

Nëna Tereze kishte shkruar atje për të kaluar Krishtlindjen.

Në kthim pati thënë kështu: “Maria e Jozefi kanë kërkuar një vendstrehim ku do të mund të lindte Jezusi. E kanë gjetur në Armeni. Jezusi ka lindur i varfër, s’kishte asgjë përpos kashtës dhe grazhdit. Varfëria e Jezu Krishtit edhe e popullit armen janë të bashkuara...”

Armenia është Golgota: vdekja. Bota ka të vrapuar në Armeni, sikurse barinjët dhe mbretërit në Betlehem...”

Dhe vazhdon: “Zoti e ka treguar madhësinë dhe bukurinë e jetës njerëzore duke u bërë njeri... Mos mendoni se dashuria, për të qenë e vërtetë, duhet të jetë e jashtëzakonshme. Jo, ajo për të cilën kemi nevojë është vazhdimësia e ndjenjës për njeriun që e duam...”

Puna jonë nuk është asgjë tjetër përpos shprehje e dashurisë për Zotin... Njerëzit janë mjeti përmes të cilit ne e shprehim dashurinë tonë ndaj Zotit...”

URATA PËR ÇIFTIN E RI MARTESOR

Hyji im, ndihmoje këtë çift martesor, që të jetë një zemër e vetme plot dashuri, jepu atyre një jetë në të cilën do të mund të jenë një zemër e vetme, në gëzim dhe në pikëllim, në shëndet dhe në sëmundje. Jepu atyre dashurinë, për fëmijët që do t'i kenë dhe bëj që shtëpia e tyre ta ketë derën e hapur për të varfër.

O Hyj, mësoji të lutën së bashku për të jetuar gjithnjë në bashkim. Amen.

(Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza – Mother Teresa, *Mësimet e dua, Teach me to Love*, Rozafa, Prishtinë, ABS Albanische Beratungsstelle Base – CH, 2003, fq. 42, 44).



Martesa e (pa)lumtur

■ SHKRUAN:
Dr. Pavao Brajša

Psikologu i njohur bashkëkohor amerikan, i cili në mënyrë të veçantë merret me problematikën e martesës dhe familjes, John Gottman përmend inteligjencën emocionale, marrëveshjen e shoqishoqme, respektin dhe konsideratën e çiftit martesor si diçka që e rrit mundshmërinë e zgjatjes së lumturisë martesore për gjithë jetën. Pra çifti martesor emocionalisht inteligjent, që merret vesh njëri me tjetrin, që respektohet dhe kanë konsideratë për njëri-tjetrin, kanë shans të mbesin bashkë dhe t'i shmangen divorcit.

Nëse i kemi para sysh të dhënat e këtij autori, që 67% e martesave përfundojnë me divorc ndërsa gjysma e tyre në 7 vjetët e parë dhe që në martesën e dytë mundshmëria e divorcit është 10% më e madhe sesa në të parën, atëherë do të mund të përfundonim që shumica e çifteve martesore nuk di të sillt me emocionet e tyre, nuk e kuptojnë njëri-tjetrin, shumë pak respektohen dhe shumë pak kanë konsideratë për njëri-tjetrin.

Sipas mendimit të psikoterapeutit të përmendur martesor martesa e palumtur rrit trezikun e sëmurjes së çiftit martesor për 35% dhe ua shkurton jetën për 4 vjet. Të martuarit lumturisht jetojnë më gjatë dhe më shëndetshëm se të divorcuarit dhe ata në martesë të palumtura njerëzit u ekspozohen streseve difuze kronike kështu që janë të kërcënuar fizikisht dhe emocionalisht. Martesa e lumtur ndikon pozitivisht në forcimin e sistemit imunologjik mbrojtës, ndërsa divorci e dobëson. Konkludimi i tij është: Po t'i kushtoj mbajtjes së martesës vetëm 10% e kohës që harkohet në javë për fitnes (kondicionin fizik), tri herë më shumë do të ishin më të shëndetshëm sesa të vraponin gjatë asaj kohe.

Fshehtësia e parë pra e martesës është zhvillimi dhe mbajtja e lumturisë martesore. Lumturia e ruan martesën, mirëpo edhe shëndetin në të. Fëmijët në martesë kanë nevojë për prindër të lumtur dhe të shëndoshë. Problemi i familjes bashkëkohore nuk është banesa, çerdhet e fëmijëve, shtesat për fëmijë, teknika e bardhë, punësimi i prindërve por edhe lumturia dhe shëndeti i tyre. Prindërit e palumtur në martesën e tyre shpejt ndahen; ndërsa nëse edhe qëndrojnë së bashku domosdo bëhen për fëmijët prindër më pak cilësorë pa marrë para sysh çka mendojnë ata për veti dhe çka dëshirojnë vetëdijshëm.

Lumturinë martesore duhet zhvilluar dhe ruajtur jo vetëm për

shkak shëndetit personal por edhe për shkak të fëmijëve për të cilët shembujt më të mirë dhe edukatorët më cilësorë janë prindërit e lumtur dhe të kënaqur në martesën e tyre. Divorci më së shpeshti nuk është zgjidhje e fatkeqësisë martesore por vazhdim i saj me një partner tjetër. Kjo nuk është as lidhja e shkurtë apo e gjatë jashtëmartesore, sepse shpesh herë sjell fatkeqësinë e shtuar për "të tretin" apo për të tretë. E vetmja zgjidhje e mençur dhe humane është të shikohet më thellë në martesën personale të palumtur dhe, nëse duhet, me ndihmën e specialistit ta shndërrosh atë në një shans dhe një cilësi të re martesore. Kjo mund të jetë gjë shumë e mirë për të dy partnerët, e ndoshta edhe më së shumti për fëmijët e tyre.

Fshehtësia e martesës së lumtur

Në librin „Shtatë fshehtësi të martesës së suksesshme“ John Gottman thekson që fshehtësia e martesës së lumtur nuk është aq në personalitetet e partnerëve bashkëshortorë sa në përshatshmërinë e tyre të dyanshme, jo aq në interesat e përbashkëta sa në sjelljen e tyre me to, jo aq në mirësjelljen e tyre të ëmbël me njëri-tjetrin, të shprehurit e tyre pozitiv, buzëqeshjen, të puthurat dhe ilkes nga konfliktet e dyanshme sa në cilësinë e miqësisë së tyre.

Si psikoterapeut martesor kam dëgjuar me mijëra herë nga partnerët bashkëshortorë sqarimet e dëshirës së tyre që të ndahen „për shkak të mospërputhjes së natyrave ...“, dallimin tepër të madh të karaktereve të tyre“. Suksesi apo mospërputhjesi i martesës nuk ndodhet në kombinimin e suksesshëm apo të pasuksesshëm të personaliteteve, karaktereve të tyre por në përshatshmërinë e tyre të suksesshme dhe të pasuksesshme. Marrëdhënia martesore ruhet me përshatshmërinë e dyanshme të përditshme dhe jo me kombinim, me punë të dyanshme për t'u bashkuar gjithnjë sërishmi dhe jo me analizimin e dyanshëm të personaliteteve dhe karaktereve. Marrëdhënia martesore është proces i gjallë i sekuentave gjithnjë të reja dhe të papërsëritshme dhe jo përsëritje e ritualizuar e zgjedhjes së suksesshme apo të pasuksesshme. Martesa është lumë që rrjedh dhe jo kënetë që qëndron dhe nuk lëvizë. Edhe suksesi në të madh i përsëritur gjithnjë në të njëjtën mënyrë – çon në mospërputhje.

Martesa e lumtur nuk bazohet në interesa gjithmonë të njëjta të përbashkëta por në bashkimin aktiv të interesave të tyre të ndryshme dhe me pasurimin e dyanshëm, pikërisht me ndry-

“Lumturinë martesore duhet zhvilluar dhe ruajtur jo vetëm për shkak shëndetit personal por edhe për shkak të fëmijëve për të cilët shembujt më të mirë dhe edukatorët më cilësorë janë prindërit e lumtur dhe të kënaqur në martesën e tyre.”

shueshmërinë e tyre.

Mirësjellja e ëmbël e shoqishoqme, të shprehurit pozitiv, buzëqeshja, puthjet dhe shmangia e konflikteve të dyanshme nuk janë kurrfarë garancie e lumturisë martesore. Në ordinancën time psikoterapeutike kam takuar shumë partnerë të ëmbël martesor gjithmonë me buzëqeshje në gojë mirëpo me aq shumë mllef dhe armiqësi të kontrolluar, paj do të mund të thosha edhe urrejtje, sa që ajo mirësjellje dhe buzëqeshje dukeshin groteske dhe qesharake. Helmo i Suzana Gastager e kanë shkruar një analizë të shkëlqyer „të martesës dhe familjes fasadë“ të cilës kurrqysh nuk përputhet me interierin.

Gottman propozon si kriter të martesës së lumtur, me këtë edhe garancinë e vazhdimësisë së saj, miqësinë ripërtëritëse të singërtë dhe cilësore, të mbajtur dhe të qëndrueshme në mes partnerëve martesorë. Partnerët martesorë si miq të singërtë janë garancinë e mirë e zgjatjes së një martesë të suksesshme.

Më duhet ta pranoj se gjithmonë e kam pyetur veten: A thua njerëzit mund ta urrejnë njëri-tjetrin aq shumë dhe t'i dëshirojnë të keqen siç po bëkan kështu partnerët martesorë kur divorcohen? Miqësia e sigurt nuk është garanci e vetme, mirëpo gjithsesi është element i rëndësishëm i një martesë të suksesshme dhe të lumtur.

Përvëq dashurisë në martesë është e rëndësishme edhe miqësia

John Gottman tërheq vëmendjen që përballimi i konflikteve dhe aftësia e komunikimit nuk janë të mjaftueshme për një martesë



të lumtur. Për këtë është e rëndësishme si të dilet sigurisht nëpër vështirësitë e saja dhe në këtë të arrish ta ruash veten të lumtur dhe martesën stabile. Këtu ndihmon miqësia e thellë martesore që është zemra e çdo martesë, si dhe konsiderata e dyanshme dhe gëzimi për shkak të bashkimit të partnerëve martesorë. Miqësia martesore e mban flakën e dashurisë martesore dhe është mbrojtja më e mirë kundër ndjenjave armiqësore të shoqishoqme në martesë.

Si psikiatër dhe psikoterapeut kam takuar me mijëra çifte martesore, si këshilltar dhe terapeut kam kaluar së bashku me ta nëpër një varg vështirësish dhe problemesh, tragjediash dhe katastrofash. Më duhet ta pranoj se shpesh herë kam hasur në armiqësi të tyre të shoqishoqme sesa në miqësi, nënçmime sesa konsideratë, urrejtje dhe hakmarrje sesa dashuri dhe falje. Shpesh herë e kam pyetur veten: A thua është kjo ai porti i qetë dhe i mbrojtur martesor në të cilin mund të qetësohesh, të pushoh dhe të mbledhësh energji të reja për një nisje të re në detin shpesh herë të rrezikshëm dhe të trazuar të hapur të jetës martesore?

Miqësia, konsiderata e shoqishoqme dhe dashamirësia, ndihmesa dhe mbështetja sigurisht nuk mund ta zëvendësojnë dashurinë martesore, mirëpo mund të jenë bazë solide, prapavijë e mirë për ri-ndezjen e saj të kohëpaskohshme. Martesa ka nevojë për dashurinë martesore, jetën seksuale martesore, mirëpo edhe „miqësinë martesore“. Do të mund ta krahasonim me „stand by“ në televizorë, kompjuterë apo linja. Kjo është gjendje e një gatishmërie të vazhdueshme për dashuri dhe jetë seksuale në mar-

tesë, por jo zëvendësim i tyre. Ky është ai minimumi që e ruan njeriun të gatshëm për maksimume të kohëpaskohshme martesore të dashurisë dhe jetës seksuale, por edhe mbrojtje dhe ruan njeriun në faza të krizave martesore dhe „fashijeve para stuhisë“ vështirë të durueshme të shkurtra apo të gjata martesore.

„Miqësia martesore“ paraqet minimumin e të qenit njeri, humanitetit, dashamirësisë, qëllimit të mirë, zemërgjerësisë, konsideratës së shoqishoqme dhe besimit të partnerëve martesor në raportet me njëri-tjetrin. Ajo luan rolin vendimtar në fazën e divorcit eventual martesor. Për fat të keq, atëherë jemi dëshmitarë që me venitjen e dashurisë martesore dhe jetës seksuale martesore në vend të tyre vjen urrejtja martesore, padurimi, hakmarrja, hedhja e fajit njëri-tjetrit, padia, lufta me mish e shpirt, dhe gjithë kjo para syve dhe në prani të fëmijëve të cilët nuk mund të besojnë që kjo është duke u ndodhë prindërve të tyre. Sa e mirëseardhur do të ishte këtu „miqësia martesore“ e singërtë dhe e ndershme! Ndoshta në skenën martesore sërishmi do të sillte edhe dashurinë martesore? Ta ruajmë me përkushtim këtë „rezervë të fundit“ të martesës sonë! Kurrë nuk e dimë kur do të na duhet, ndoshta edhe të na shpëtojë martesën.

Me rënien në dashuri zakonisht martesën e fillojmë, me dashuri do të ishte dashur ta vazhdojmë ndërsa me miqësi të singërtë martesore ta ruajmë në kriza të shkurtra apo të gjata martesore!

(Përkthet:
P. Shjefën Dodes SJ)

Shën Valentini, pajtori i të dashuruarve

■ SHKRUAN:
Don Dominik QERIMI

Fort të dashur të rinj!

Edhe pse në të njëjtën ditë ne kremtojmë festën e dy prej pajtorëve të Evropës që janë shën Cirili e Metodi, megjithatë tashtë është bërë një 'fakt i kryer', një traditë e pandalshme fakti se data 14 shkurt është e njohur si dita e shën Valentinit, "Valentine day", dita e të dashuruarve.

Të shkruash mbi kuptimin e të qenit i dashuruar, do të thotë të shkruash mbi vetë Dashurinë. Të shkruash mbi dashurinë do të thotë të shkruash mbi Hyjin, sepse "Hyji është dashuri!" (1 Gjn 4, 18).

Shembulli e vërtetë të kësaj Dashurie në emrin e Jezusit e Nazaretit që është Dashuria e Zotit e bërë njeri dhe të gjithë shembujt tjerë nuk janë tjetër veçse imitimi i këtij SHEMBULLI. Shembuj të tjerë të dashurisë hyjnore në gjejmë në shumë shenjtë të tjerë duke filluar nga Virgjëra Mari, Nëna e Hyjit, Nëna e dashurisë. Shembuj të tjerë që kanë vdekur duke luftuar në përpjekje për t'i ngjarë Jezusit janë shenjtërit. Me siguri një prej këtyre shembujve është edhe shën Valentini, i quajtur edhe shenjtë i të dashuruarve.

Prandaj njëkohësisht që kërkon ndërmjetësinë e shën Valentinit mbi të gjithë atë që ndjehen dhe janë të dashuruar, ju ofroj këtë artikull mbi jetën e shën Valentinit, me shpresë që shembulli i tij t'ju nxisë t'i jepni kësaj dite një kuptim të thellë shpirtërorë, sikur siç duhet ta ketë dashuria e krishterë. Dashuria e vërtetë, e çdo personi, e çdo kohe dhe çdo hapësie, nëse vërtetë është dashuri ka burimin e saj në vetë Zotin, që është Dashuri. Prandaj, të jesh i vërtetë i dashuruar do të thotë të bëhesh paqyrrë e DASHURISË SË ZOTIT.

Ndonëse në rastin e kësaj dite, të paraprirë nga një fushatë e gjerë parapërgatitore, ne jemi të bombarduar nga reklamata dhe publiciteti komercial që i bëhen kësaj feste, megjithatë mendoj se është rasti që si të krishterë të pyesim vetën: 'Kush është në të vërtetë shën Valentini emrin e të cilit e bart kjo festë?' dhe 'Cila është porosia e tij për ne, për të jetuar si "të dashuruar të krishterë" e jo si të dashuruar pagan?'.

Jeta e Shën Valentinit, ipeshkëvet dhe martir

Shën Valentini, i quajtur edhe shën Valentini nga Terni (IT), ose shën Valentini nga Interamna lindi rreth vitit 176 dhe vdiq në vitin 276 në Romë. Ishte ipeshkëvet dhe martir i krishterë. Është i ndëruar si shenjtë në Kishën Katolike, në Kishën Ortodokse dhe më pas edhe nga Kisha anglikane dhe është i konsideruar si pajtori i të dashuruarve.

Ndonëse ë "Martirologun

Romak", që është katalogu i të gjithë shenjtëve universal dhe lokal, në këtë datë gjejmë dy martir me emrin Valentin njëri ipeshkëvet dhe tjetri meshtar, megjithatë të dhënat historike tregojnë se sipas çdo gjase bëhet fjalë për të njëjtën person.

Një burim më i gjerë për sa i përket jetës dhe mrekullive të shën Valentinit është "Passio Sancti Valentini" i shek. V-VI dhe në të cilin shën Valentini quhet "Interamnensis episcopus", "Civis Interamnensis urbis".

Pasi u kthye në besimin e krishterë ia kushtoi jetën e tij bashkësisë së krishterë dhe qytetit të Temit ku po shpërthente me tërbim përndjekja kundër ndjekësve të Jezusit. Në vitin 197 u shugurua ipeshkëvet i Temit nga shën Feliciani nga Folinjo.

Në vitin 270 Valentini gjendej në Romë, për të predikuar Ungjillin dhe për të kthyer paganët dhe i ftuar nga oratori i famshëm grek dhe latin Kraton me shpresën që Valentini t'ia shëronte djalin nga sëmundja e cila e kishte bërë atë të kërrusej aq shumë në shpinë sa që koka e tij i qëndronte mes gjunjëve. Pasi Valentini ia shëroi djalin nga sëmundja Kraton i kthye në besimin e krishterë dhe bashkë me të edhe tërë familjen e tij dhe studiuesit grek dhe latin Prokulin, Efebin, Apolonin dhe Abondin, birin e prefektit të qytetit të Romës.

Ky lajm, bashkë atë të martesës që Valentini kishte lidhur mes një të krishterë dhe një ish-pagani legjionar romak (Sabini dhe Serapia) u bënë tepër të bujshëm, aq sa kur prefekti Placidi mori vesh, e burgosi Valentinin duke u përpjekur më kot që ta shtynte atë që t'i paraqiste flajmë hyjnore të tyre. Valentini asses nuk pranoi ta bënte këtë.

I ftuar nga perandori Klaudio II i quajtur 'Gotiku' në sallën e tij mbretërore për të ndërprerë kremtimin fetar dhe për të mohuar fenë e tij, ai e refuzoi këtë gjë dhe jo vetëm kaq, por u përpoq ta kthente perandorin në besimin e krishterë. Klaudio II nuk e vrau por e dënoi me arrest shtëpiak duke ia besuar kujdesin e tij një familjeje fisnike romake në shtëpinë e prefektit Asterio. Gjatë qëndrimit të tij në këtë shtëpi Valentini e bëri edhe një mrekulli duke ia kthyer shikimin vajzës së prefektit e cila ishte e verbër.

Valentini u arrestua për herë të dytë gjatë sundimit të Aurelianit, i cili kishte zëvendësuar Klaudion II. Perandoria vazhonte përndjekjet e saj kundër të krishterëve dhe kundër krerëve të Kishës së Romës, e meqenëse fama e Valentinit shkonte gjithnjë duke u rritur, ushtarët romak të udhëhequr nga prefekti i qytetit Furius Placidi, sipas urdhrat të



perandorit Aurelian e kapën dhe e nxorën jashtë qytetit në rrugën Flaminia për ta frushkulluar, meqë kishin frikë se brenda qytetit populli do të çohet në mbrojtje të tij.

Valentinin pasi e frushkulluan e vranë duke ia prerë kokën më 14 shkurt 273.

Festa e Shën Valentinit: mes origjinës pagane dhe përfitimve tregtare

Ndonëse figura e shën Valentinit është e njohur edhe për shkak të porosisë së dashurisë që sjell ky shenjtë, lidhshmëria specifike me dashurinë romantike dhe me të dashuruarit është pothuajse me siguri e një periudhe të mëvonshme, por çështja e origjinës së saj është e diskutueshme.

Zanafilla e festës së të dashuruarve duket se është një përpjekje e Kishës katolike që t'i jepte fund një rit pagan të pjellorisë. Për romakët e lashtë muaji i shkurtit ishte i konsideruar periudha në të cilën bëhej përgatitja për ardhjen e pranverës, stinë kjo e mbajtur si periudhë e rilindjes. Gjatë mesit të muajit fillonin kremtimet e Lupercalit (hyjnitë që mbanin ujërit larg nga fushat e kultivuara). Që nga shekulli IV para K. romakët, italikë dhe grekët pagan më 15 shkurt ndëronin hyjnitë Pane, Fauno e në mënyrë të veçantë hyjin Lupercus me një rit të caktuar vjetor. Luperinjtë, rregulli i priftërinjve të këtij kulti, shkonin në shpellën në të cilën sipas legjendës së tyre ujkonja u kishte dhënë gj Romulit dhe Remit dhe aty paraqisnin flajmë e përshtatshme. Gjatë rrugëve hidhej gjaku i disa kafshëve, si shenjë e pjellorisë.

Porse rituali i vërtetë për rininë romake qëndronte në një lloj lotarie të dashurisë. Emrat e grave dhe të burrave që adhuronin këtë hyjni vendoseshin në një enë të madhe dhe përzieheshin. Atëherë një

fëmijë zgjedhte rastësisht disa çifte të cilët për një vit të tërë duhej të jetonin në intimitet, në mënyrë që kështu riti i pjellorisë të plotësohej. Vitin e ardhshëm çdo gjë fillonte nga e para me çifte tjera.

Si në rastin e shumë festave tjera pagane, kështu edhe në rastin e festës së Lupercalit, Kisha e vetëdijshme se këto festa ishin bërë pjesë e rregullt e jetës popullore dhe se do të ishte e vështirë apo e pamundur që ato të asgjësoheshin, veproj si një pedagog e mirë që di të marrë për dorë fëmijët e saj për t'i drejtuar në udhën e drejtë. Kështu Kisha është përpjekur të largojë popullin dhe besimtarët nga këto rite pagane, shumë herë të shturura dhe të pamoralshme dhe të zëvendësonte ato me kremtime të krishtera që përputheshin pak a shumë me kuptimin e mirë të atyre festave. Pikërisht duke u nisur nga kjo logjikë e urtisë së Kishës, ajo vendosi që t'i jepnin fund kësaj praktike të shturur. Për të bërë këtë Etërit e Kishës kanë kërkuar një shenjtë të të dashuruarve për të zëvendësuar Lupercusin e pamoralshëm. Kështu në vitin 496 pas Krishtit, papa Gjelazio e anuloi këtë lotaritë e dashurisë me prejardhje pagane, duke e bërë të jashtëligjshme dhe nga ty filloi të përhapet kulti i shën Valentinit.

Në kohët e mëvonshme festa e shën Valentinit mori shumë aspekte dhe karakteristika të reja. Veçanërisht në vendet e kulturave anglosaksone, të imituara këto edhe në vende tjera, karakteristika më e theksuar e festës së shën Valentinit («Valentine days») është bërë shkëmbimi i 'valentine', kartolinave të dashurisë.

Duke filluar nga shek XIX kjo traditë ka nxitur një prodhim industrial dhe tregtar në një shkallë të gjerë të kartolinave të dashurisë të kushtuara kësaj dite. Sipas Greeting Card Association, çdo vit më 14 shkurt me rastin e festës së shën Valentinit dërgohen diku rreth një miliard kartolina, numër ky që këtë festë e vendos në vend të dytë sipas kartolinave të dërguara, menjëherë pas festës së Krishtlindjes.

Por me kalim të kohës kartolinat e dashurisë janë duke u zëvendësuar nga kutitë me çokolllata, nga buqetat me lule, nga xhevahiritë e artë dhe nga dhuratat tjera të promovuara sipas nxitjes dhe interesit të reklamave komerciale.

Mrekullitë e Shën Valentinit mes historisë dhe legjendave

Janë të shumta historitë që janë bërë pjesë të kulturës popullore për sa i përket jetës së shën Valentinit. Këto histori janë të pëzier me

së vërtetës gojëdhënave dhe legjendave mbi figurën e shën Valentinit. Ne do sjellim këtu një më të famshmen mes historive dhe legjendave mbi jetën e tij.

Ngjarjet që kanë të bëjnë me shën Valentinin janë mjaftë konfuze, por megjithatë rreth personit të tij sillen mjaft tregime dhe legjenda dhe që të gjitha kanë të bëjnë me episode dashurie.

Historia/legjenda e Sabinit dhe Serapisë

Kjo histori/legjendë është më e përhapura për sa i përket jetës së shën Valentinit dhe marrëdhënies së tij me të dashuruarit. Sipas saj tregohet se një i ri centurion romak i quajtur Sabini, duke kaluar nëpër sheshin e temit, e pa një vajzë të bukur me emrin Serapia dhe u dashurua në të marrëzisht. Sabino i kërkoi prindërit të saj që ta martohej me të, por ata e refuzuan këtë gjë kategorikisht: Sabini ishte një pagan ndërsa familja e Serapisë ishte e besimit të krishterë. Për të kaluar këtë pengesë, Serapia e bukur i sugjeroi Sabinit që ai të shkonte tek ipeshkvi i tyre Valentini dhe të afrohej me besimin e familjes së saj dhe të merrte pagëzim, gjë që ai e bëri menjëherë në emër të dashurisë që kishte për të. Ndërkohë që Sabini po përgatitej për pagëzim dhe martesë, por për fat të keq Serapia u sëmurë rëndë nga tuberkuloza. Atëherë Sabini kërkoi që ta çonin atë tek shtrati i të sëmurës e cila ishte në buzë të vdekjes. Sabini iu përgjerrua Valentinit që ai mos të ndahej nga e dashura e tij, meqë jeta e tij pa të do të ishte vetëm një vuajtje e madhe. Valentini e pagëzoi Sabinin dhe i bashkoi dy të rinjtë në kuroren e martesës. Ndërkohë që ai po i lartësonte duart për t'u dhënë bekimin përfundimtar të kremtimit një qetësi e lumtur i mbështolli dy të rinjtë që kaluan në amshim.

Trupat e dy të rinjve u varrosën së bashku dhe kërkimet arkeologjike në Pentina kanë zbuluar një sarkofag që mbante brenda kufomat e dy të rinjve dhe që kështu kanë konfirmuar vërtetësinë e këtij fakti.

Dëshiroj të mbyll këtë artikull me fjalët e lutjes së një shenjtë që në Kishë njihet si një shenjtë i dashuruar:

"Votë të dashurova, o bukur i aq e lashtë dhe aq e re, vonë të dashurova. Dhe ja se ti ishe brenda meje, ndërsa unë jashtë dhe atje të kërkova. Kurse unë, i shëmtuar, vërrotesha mbi gjërat e bukura që Ti i ke krijuar. Ti ishe me mua kurse unë nuk isha me ty. Më thirrë, bërtitë, e theve shurdhësinë time. Mi more sytë, më vetëtime dhe më në fund e shërove verbërinë time. Të shijova dhe tani kam urë dhe etje për ty. Më preke dhe tani digjem nga dëshira për të fituar paqen tënde." (nga "Rrefimet" e shën Augustinit)

Të mëdhenjtë për Hyjin dhe besimin

Gjithçka që bënte, theksonte se e bënte me ndihmën e Zotit. Kështu, për shembull, kur kishte punuar në përpunimin e një vepre të tij të njohur, në faqen e fundit kishte shkruar: "E përfunduar me ndihmën e Zotit". Po kështu, kur fliste për edukimin e fëmijëve, ngultas kërkonte që fëmijët të mermin edukim nga bindjet e krishtera. Për këtë arsye iu kishte drejtuar Këshillit të

qytetit të Vjenës me fjalët: "Vetëm në themelet e krishtera mund të edukohen njerëzit e vërtetë". A e dini se kush ishte ky, i cili mendonte, fliste dhe shkruante kështu? Ishte, sikurse thonë të shumtët, kompozitori më i madh i të gjitha kohërave...

LUDWIG VAN BEETHOVEN


Kur e pyesnin Beethovenin se çka e frymëzonte në krijimin



e veprave muzikore, prej nga i vijnë idetë, përgjigjej se as ai vetë nuk e kishte të qartë këtë gjë. Kompozitori thoshte: "Ato vijnë prej dikaj, më rrethojnë në formë aq të fuqishme e aq të qartë, sa që mund t'i kap me dorë". Theksonte se meloditë e veprave të tij gjenden në natyrë, në pyll, në shëtitje, në qetësi, në ag të mëngjesit, e veçanërisht, në gjendjet e tij shpirtërore. Dhe vazhonte: "Ato gumëzhijnë, tingëllojnë, jehojnë, kumbojnë, shushuritin, vetëtojnë, derisa në fund të mos shndërrohen në tinguj dhe nota të vogla".

Bashkëkohësit e tij të shumtë, e posaçërisht ata të cilët kanë jetuar me të ose në afërsinë e tij, flasin dhe shënojnë se në çmënyrë ky mjeshtër i madh i krijonte veprat e tij gjeniale. Mes tjerash, është shënuar se si Beethoveni zgjohej shumë herët në mëngjes dhe para orës gjashtë ulej pranë tavolinës dhe punonte. Ishte ky krijimi i ritmit me duar e me këmbë, pëshpëriste diçka të pakuptueshme dhe më pas shënonte. Gjithashtu e kishte zakon që shpesh të dilte në natyrë. Duke u shëtitur nëpër fusha, pyje dhe buzë lumit "shytyhej" me shushurimat, lëvizte me duar dhe vazhdimisht shënonte diçka në fletoren e tij.

Djaloshi Ludwig u lind më 16 ose 17 dhjetor të vitit 1770 në Bonn të Gjermanisë. Mësuesi i tij i parë ishte babai, e më vonë e zgjeronte gjithnjë e më shumë dijen e tij duke i rënë pianos dhe orgjeve.



Kompozimet e tij filluan qysh në rininë e tij. Më pas bëhet nxënës i mësuesve më të njohur vinez të muzikës. Mbante koncerte të shumta rreth e përqark Europës. Beethoveni punonte palodhshëm duke kompozuar pjesë për piano, kompozime të ndryshme kamertale e deri tek simfonitë e famshme. Kush nuk ka dëgjuar për "Eroica-n" e tij, për Simfoninë e VII dhe VIII, si edhe për realizimet e tij të tjera të njohura në mbarë botën. As sëmundjet e as shurdhësia në ditët më të

moshuara, nuk kanë mundur ta ndalojnë mjeshtër të madh që të punojë palodhshëm.

Ka vdekur në Vjenë, më 26 mars të vitit 1827, ndërsa tingujt e muzikës së tij jehojnë sot e kësaj dite nëpër mbarë botën. Për të janë shkruar me mijëra faqe të librave të ndryshëm, kurse ne po e përfundojmë këtë faqe mbi Beethovenin e madh me fjalat e tij: "Me ndihmën e Zotit!"

B.P. (Branko Pilaš),
përktheu m. Teuta A.

Një "JO" e madhe Vëllaut të Madh (Big Brother)

Duke shfletuar revistën e fëmijëve MAK – "Mali Koncil" të Kroacisë, të vitit 2004, e gjeta një artikull që mu duk i përshtatshëm ta përkthej sepse është aktual për ne në Kosovë tani.

Në kohën e fundit artikujt e gazetave dhe ekranet televizive janë plot me "Big Brother" e me "Shtëpinë tonë"... Ndoshta edhe ju vetë jeni nxënë në rrjetën e tij, ndoshta jeni "kapur" edhe ju për këtë emision, edhe pse prindërit e mësuesit me siguri vazhdimisht ju thonë se ky emision është i pafrytshëm dhe humbje kohe, dhe se këtu nuk do të shihni e as nuk do të mësoni asgjë të dobishme e të mençur. Që të mos thoni se tani edhe ne po ju përsërisim po ato gjëra që i keni dëgjuar njëqind herë, po ju sjellim këtu fjalët e moshatarëve tuaj, nxënësve të klasës së gjashtë, të cilët në orën e katekizmit kanë menduar dhe kanë dhënë mendime për këtë "rriqen televizive"... Ja se çka kanë shënuar ata në fletoret e tyre, e bashk me ta mendoni edhe ju!

Më fajtorët – "të mëdhenjtë" dhe "përgjegjësit"

"Big Brother" vërtetë shikohet me të madhe, prandaj regjisor i ka pasur nevojë ta thërras në emision edhe psikologun. Ajo, siç thanë, e ka rolin t'ju ndihmojë njerëzve në shtëpi dhe t'i drejtojë shikuesit kah gjërat prej të cilave mund të mësojnë diçka për veten e vet... Mendimi im është komplet ndryshe! Duke e shikuar këtë çmenduri, mendoj

se vetëm mund t'i bëjnë dëm vetes. Personat të cilët gjenden në shtëpinë Big Brother dëshirojnë të eksponohen, duke mos shikuar fare se a do të jetë kjo në aspektin pozitiv apo negativ. Ata mendojnë se duke u zhveshur, duke pirë duhan e duke u sjellur paturpësisht e përparojnë shëndetin e kombit. Mashtrohen! Mendoj se faji më i madh është tek ata që janë "përgjegjës", të cilët i lejojnë këto emisione! A

e pyesin veten këta të "mëdhenj" se çka do të bëhet me këta të rinj kur të dalin prej kësaj shtëpie? A do t'ju duhet atëherë ndihma e psikologut? Mendoj se përmes këtij emisioni neve të rinjë na jepet porosia se si mund të bësh para e jo të punosh. Ky amorali e ka kaluar çdo kufi. Pyetem çka të shikoj në TV kur ky "super" emision e ka zënë mu atë termin kur ne fëmijët kemi kohë të shikojmë televizion. I

porosis përgjegjësit, të rinjtë e të gjithë njerëzit: le ta marrim armën e Zotit në duar tona dhe le të luftojmë kundër së keqeve. Të lutemi, të lutemi, të lutemi... – Josipa Radoš

Çka s'bëjnë njerëzit...

Çka s'bëjnë njerëzit për famë, e mediat e dinë këtë... Çka s'janë disa të gatshëm të bëjnë për mijëra euro, bile edhe shpirtin t'ia shesin djallit, fatkeqësisht! Unë nuk kisha mundur ta bëj një gjë të tillë! – Stipe Brnić

Pse të shikosh e pse të mos shikosh?

Po: Big Brother duhet shikuar sepse duke e shikuar këtë emision mësojmë dhe kuptojmë çka nuk duhet bërë në jetë.

Jo: Big Brother nuk duhet shikuar sepse kandidatët bëjnë gjëra të pista, budallaqe dhe shajnë. Me një fjalë, bëjnë gjithçka që të krishterëve të vërtetë nuk u ka hije! – Ivana Klarić


(Përktheu dhe përsëriti:
m. Teuta)





TA NDIHMOJMË NDËRTIMIN E KATEDRALES

Faleminderit!



Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë:
Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.

Emri: _____

Mbiemri: _____

Adresa: _____

Qyteti: _____

Kodi postar: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

